**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 971/ 13 prot. Datë 11.06.2024

**V E N D I M**
**Nr. 667/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 11.06.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Euro Mega 2010"* SHPK, në procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-96420-02-26-2024, me objekt "*Blerje detergjent, për Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve"*, me fond limit 39,951,333 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Malvina Visoka*" PF, dhe operatori ekonomik "*AN&RA"* SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit

**Ankimues:** Operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK me NIPT K91624505A, me adresa: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001, Tiranë.

| | |
|---|---|
| **Subjekt i interesuar:** | Operatori ekonomik "*Malvina Visoka*" PF me NIPT L61608005C, me Adresa: Rruga "Muhamet Veliu", Pallati Iliada, Shk. 1, Kati. 1, Linzë, Tiranë.<br><br>Operatori ekonomik "*AN&RA"* SHPK me NIPT K12205001I me Adresa: Rruga "Barrikadave", Hyrja. 3, Ap. 10, Ish Kinema 17 Nëntori, Tiranë.<br><br>Agjencia Prokurimit Publik.<br>Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave, Tiranë.<br><br>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).<br>Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Tiranë. |
| **Baza Ligjore:** | Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".* |

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.02.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me Nr. REF-96420-02-26-2024, me objekt "*Blerje detergjent, për Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve"*, me fond limit 39,951,333 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 20.03.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 05.04.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | "Atlantik 3" SHPK | pa ofertë ekonomike skualifkuar | |
| 2. | "Get Klin" SHPK | pa ofertë ekonomike skualifkuar | |
| 3. | "Anbim" SHPK | 21.965.000 | lekë skualifkuar |
| 4. | "Besim Kamberi" PF | 26.945.000 | lekë skualifikuar |
| 5. | "Euro Mega 2010" SHPK | 33.655.000 | lekë skualifikuar |
| 6. | "Malvina Visoka" PF | 33.750.000 | lekë kualifikuar |
| 7. | "An&RA" SHPK | 33.808.000 | lekë kualifikuar |
| 8. | "Murati D" SHPK | 34.761.000 | lekë skualifkuar |

II.4. Në datën 05.04.2024, operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*I. Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesën në DST për numrin e ofertave të lejuara në procën e prokruimit nga një ofertues pasi rezulton se ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Konkretisht EUROMEGA 2010, ka ngarkuar në SPE dy oferta ekonomike në vlerat: Oferta 1: 33,650,000 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë)Oferta 2.: 27,320,000 (njzetë e shtatë milion milion e treqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë).Referuar DST Seksioni i Përgjithshem në këtë procedutrë nuk lejohet më shumë se 1 ofertë ose ofertë alternative. Në zbatim të nenit pikës 4 të nenit 79 të*

*VKM nr.285 dt.19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative dhe për këtë arsye subjekti EUROMEGA 2010 s'kualifikohet nga renditja në këtë procedurë dhe ofertat refuzohen.*

II.5. Në datën 15.04.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "*Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak*", për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 22.04.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2024/3998, protokolluar me nr. 971/2024, datë 22.04.2024, e operatorit ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike dhe kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë "*Malvina Visoka*" PF dhe "*AN&RA*" SHPK me përmbajtje si vijon:

*Pasi u njohëm me këtë vendim të Komisionit të vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës tonë duke vlerësuar se ky vlerësim është bërë në kundërshtim me ligjin, rregullat e prokurimit publik, me manualin teknik të APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë, të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021, me manualin teknik të APP-së për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronikeë, të miratuar me udhëzimin e APP-së Nr. 07, datë 30.07.2021, brenda afatit ligjor, brenda 7(shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit (paraprak) të procedurës së prokurimit në SPE, po ju paraqesim kundërshtimet tona si më poshë vijon:*
*I. Në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së shoqërisë Euro MEGA 2010 SHPK, si më poshtë: ...Operatori ekonomik euro Mega 2010 SHPK nuk plotëson kërkesën në DST për numrin e oferave të lejuara në procedurën e prokurimit nga një ofertues pasi rezulton se, ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Komkrestisht EURO MEGA 2010, ka ngarkuar në spe dy oferta ekonomike. Konkretisht EURO MEGA 2010, ka ngarkuar në SPE dy oferta në vlerat: oferta 1; 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke (pa TVSH) ( me numra dhe fjale) dhe oferta 2: 27,320,000 (njezetë e shtatë milion e treqinde njezetë mije) Leke (pa TVSH) (me numra dhe fjale). Referuar DST Seksioni i pergjithshëm në këtë procedurë nuk lejohet më shumë se 1 ofertë ose ofertë alternative. Në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 për Miratimin e rregullave të prokurimit publikë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofert, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative dhe për këtë arsye subjekti euromega 2010 SHPK síkualifikohet nga renditja në këtë procedurë dhe ofertat refuzohen: paraqesim kndërshtimet tona si më poshtë:*

*Së pari:*
*Shoqëria Euro Mega 2010 shpk, ka hartuar dhe ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve të gjitha dokumentet e saj të ofertës në përputhje të plotë me ligjin, rregullat e prokurimit publik dhe me manualet e agjencisë së prokurimit publik. Konkretisht legjislacioni i prokurimeve parashikon: në nenin 4 (përkufizime) të ligjit nr 162, datë 23.12.2020 për*

*prokurimin publik përcaktohet: Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: .... 29. Mjet elektronikë është pajisje elektronike për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave (përfshirë këtu edhe përpunimin digjital) që transmetohen, jepen e merren përmes kabllove, radios, mjeteve optike ose ádo mjeti tjetër elektromagnetik.*
*41. Sistem i prokurimit elektronikë është një bazë të dhënash shtetërore, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi e që përdoret për kryerjen e procedurave të prokurimit publik dhe administrohet nga agjencia e prokurimit publik.*
*Në nenin 17 (forma e komunikimit), të ligjit nr 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publik përcaktohet: 1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në zbatim të këtij ligji kryhen duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit. Përjashtimisht, komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit mund të kryhen në formë shkresore, sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Rastet kur mund të përdoret komunikimi në rrugë shkresore përcaktohen me vendim të këshillit të ministrave.*
*2. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe parashikimet e këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik si më poshtë:*
*a) informacionet që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara;*
*b) mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës.*
*3. Në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor komunikon në formë elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jodiskriminuese, të disponueshme dhe të ndëroperueshme me produkte të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, të cilat përdoren gjerësisht. Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen me vendim të këshillit të ministrave.*
*4. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.*

*Forma e përdorur për komunikim, shkëmbim dhe ruajtjen e informacionit duhet të garantojë se autoriteti ose enti kontraktor mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor ligjor për dorëzimin e tyre, i përcaktuar nga ky ligj.*

*Në nenin 23 (Kompetencat e agjencisë së Prokurimit Publik) të ligjit nr 162, datë 23.12.2020 për prokurimin publik përcaktohet: Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:*
*b) nxjerr vendime, udhëzime dhe rekomandime për mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik;*
*ç) jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik;*

*f) menaxhon bazën e të dhënave të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik;*
*l) bashkëpunon me autoritetet kontraktore, Komisionin e Prokurimit Publik, institucione të tjera, si dhe organet audituese, nëpërmjet informacioneve të ndryshme, për cështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik, në funksion të efikasitetit të këtij sistemi;*
*Në nenin 1 (përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, përcaktohet:*
*1. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020, për prokurimin publikë (në vijim, LPP), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim, APP), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së*
*Në neni 87 (mënyra e zhvillimit të procedurave me mjete elektronike) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, përcaktohet: mënyra e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.*
*Në neni 115 (udhëzime dhe manualet shpjeguese) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, përcaktohet:*
*"APP-ja harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për tju ardhur në ndihmë të gjitha palëve gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit. Në manualin e APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021 për miratimin e Manualit për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë në faqet 23 dhe 24 të tij, citohet shprehimisht se, ...Në dritaren e katërt seksioni i oferta ekonomike, operatori ekonomik duhet të ngarkojë vetëm ofertën ekonomike, e cila enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit... Ky dokument, pasi ngarkohet në sistem enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit por në datën e hapjes së procedurës nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave do bëhet e lexueshme... KUJDES: NËSE TENTONI TË SHTONI NJË DOKUMENT TJETËR NË KËTË SEKSION, SISTEMI NUK DO JU LEJOJË... Në këtë rast, ju duhet të bëni në fillim fshirjen e dokumentit të ofertës së parë të bashkangjitur në sistem me anë të butonit fshi dokument dhe pasi të keni ruajtur veprimet tuaja, mund të bashkangjitni një dokument tjetër në këtë seksion me anë të butonit shto dokument. Pasi të keni përfunduar me bashkëlidhjen e të gjithë dokumenteve, pjesë e ofertës tuaj për këtë procedurë prokurimi, klikoni butoni hapi tjetër dhe zgjidhni opsionin e përfunduar për për të dorëzuar ofertën tuaj pranë autoritetit kontraktor dhe më pas klikoni butonin hapi tjetër. Në këtë moment, oferta juaj do të kalojë te skedari tenderat e mi oferta të dorëzuara.*
*Në manualin teknik të APP-së për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike, të miratuar me udhëzimin e APP-së Nr. 07, datë 30.07.2021, në faqen 86 dhe 87 të tij, në mënyrë të qartë është përcaktuar:*
*Kujdes: Te paneli formulari i ofertës, ngarkohet vetëm një dokument, e cila enkriptohet duke mundësuar një ruajtje të informacionit të hedhur në sistem deri në hapjen e ofertave. Emërtimi i dokumenteve të bashkëlidhur në këtë skedar do të marrë si prapashtesë një numër nga sistemi. Ne rast se, shfaqet një error gjatë procesit të hapjes së ofertës si dhe kur oferta ekonomike iu*

*shfaqet e enkriptuar anëtarëve të Komisionit të vlerësimit të Ofertave, atëherë autoriteti/entikontraktor duhet të dërgojë në agjencinë e Prokurimit Publik një kërkesë zyrtare, ku të saktësohet objekti i procedurës dhe numri i referencës në sistem, në mënyrë që të bëhen verifikimet e duhura për errorin e shfaqur si dhe të bëhet i mundur procesi i dekriptimit për ofertën ekonomike të dorëzuar nga operatori ekonomik. Sa më sipër cituam, mënyra e ofertimit nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimeve nga ana e operatorëve ekonomikë është e përcaktuar qartë në aktet ligjore, nënligjore si dhe në manualet teknike të hartuara e miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, dhe referuar pikërisht këtyre manualeve, teknikisht operatori ekonomik nuk mund të ngarkojë tek paneli formulari i ofertësë më tepër se një dokument, pra teknikisht sistemi nuk të lejon të ngarkosh dy dokumenta, të cilat referuar rregullave teknike duhet të jenë në formatin PDF, ku të jenë pasqyruar shtojcat Shtojca 1 (Formulari i ofertës) dhe Shtojca 2 (Listat e cmimeve të artikujve), pra oferta ekonomike.*
*Ne manualin e APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021, në faqen 26 të tij përcaktohet: Kujdes: Të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, kanë të drejtë të heqin, të bashkëlidhin dokumente të reja në procedurat e prokurimit apo të tërheqin të gjithë ofertën, deri në datën dhe orën e përcaktuar në sistem si afati i fundit për pranimin e ofertave nga autoritetet kontraktore.*

*Nga ana e shoqërisë Euro Mega 2010 SHPK, përpara orës 11:00 që ishte dhe afati i i fundit për pranimin e ofertave, e konkretisht në orën 10:56, është bërë një ndryshim në ofertën e dorëzuar e cila ishte në statutusin e përfunduarë, duke respektuar rigorozisht Manulin teknik të APP-së.*

*KONKRETISHT: Shoqëria Euro Mega 2010 SHPK, ofertën ekonomike si shtojcën 1 dhe shtojcën 2 të DT-së i ka hedhur në një dokument të vetëm në formatin e kërkuar pdf, vetëm në këtë dritare, pra jo ne driteret e tjera. Më datë 19.03.2024, ora 14:28, shoqëria Euro MEGA 2010 SHPK, ka përfunduar hedhjen e të dhënave në llogarinë e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik, vërtetuar ky fakt me mesazhin e ardhur në SPE, në këtë orë dhe në këtë datë. Tek dritarja formulari i ofertës, tek skedari bashkëngjitur është ngakuar dokumenti në PDF i emërtuar oferta ekonomike i cili pasi është hedhur ne SPE është inkriptuar me të dhenat: oferta ekonomike 6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf. Në këtë dokument janë përfshirë dhe gjenden shtojca 1. Formulari i ofertës dhe shtojca 2. Listat e cmimeve të artikujve, pra oferta ekonomike e cila në këtë moment është ofertuar nga ana e shoqërisë tonë në vlerën 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke (pa TVSH). Oferta ka marrë numrin në SPE offer-8040/11032024. I njëjti emërtim në lidhje me ofertën ekonomike rezulton të pasqyrohet edhe në mesazhin e ardhur tek rubrika mesazhe, në llogarinë tonë në SPE, ku është konfirmuar fakti se, oferta jonë offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve) u dorëzua. Në këtë mesazh, në listën e dokumenteve të ofertës, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar oferta ekonomike 6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf. Më datë 20.03.2024, përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave për këtë procedurë prokurimi, shoqëria Euro MEGA 2010 SHPK, vendosi të ndryshojë vlerën e ofertës ekonomike të ofertuar për këtë procedurë. Pasi u*

*kryen nga ana e shoqërisë tonë të gjitha veprimet në SPE, në përputhje të plotë me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik të APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021 për miratimin e Manualit për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë, ky ndryshim u pasqyrua në SPE më datë 20.03.2024 ora 10:56. Konkretisht, tek dritarja formulari i ofertës, tek skedari bashkëngjitur është ngarkuar dokumenti në PDF i emërtuar oferta ekonomike finale i cili pasi është hedhur ne SPE është inkriptuar me të dhenat: oferta burgjeve FINALE_10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf. Në këtë dokument janë përfshirë dhe gjenden shtojca 1. Formulari i ofertës dhe shtojca 2. Listat e cmimeve të artikujve, pra oferta ekonomike e ndryshuar, me vlerë totale 27,320,000 (njezetë e shtatë milion e treqinde njezetë mije) Leke (pa TVSH). Më datë 20.03.2024, ora 10:56, nëpërmjet mesazhit të ardhur tek rubrika mesazhe, në llogarinë tonë në SPE, është konfirmuar fakti se, oferta jonë offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve) u dorëzua. Në këtë mesazh, në listën e dokumenteve të ofertës, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar oferta burgjeve FINALE_10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf. Më datë 20.03.2024, ora 11.00, ka përfunduar afati për dorëzimin e ofertave për procedurën me të dhënat e mësipërme, për të cilën shoqëria Euro MEGA 2010 SHPK sic shpjeguam më lart dorëzoi ofertën e saj. Shoqëria Euro Mega 2010 SHPK, ka në llogarinë e saj në SPE, të gjitha mesazhet elektronike që vërtetojnë të gjitha veprimet e kryera nga ana jonë në lidhje me ndyshimet në ofertën tonë, janë bërë konform rregullave e dokumentuar si më poshtë: Mesazhi në SPE i ores 19.03.2024 ora 14:28 (mesazhi i cili vërteton se, oferta jonë offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve) u dorëzua. Në këtë mesazh, në listën e dokumenteve të ofertës, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf me vlerë: 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke (pa TVSH). Oferta ka marrë numrin në SPE offer-8040/11032024. Mesazhi në SPE i datës 20.03.2024 ora 10:56, vërtetohet dhe konfirmohet fakti se, janë fshirë dokument nga oferta e konkretisht është fshirë dokumenti: oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf. Mesazhi në SPE i datës 20.03.2024 ora 10:56, mesazh i cili provon dhe konfirmon se oferta offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve), ka marrë statusin e papërfunduar. Mesazhi në SPE i datës 20.03.2024, ora 10:56, i cili provon dhe konfirmon se, oferta jonë offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve) u dorëzua. Në këtë mesazh, në listën e dokumenteve të ofertës, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar oferta burgjeve FINALE_10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf, që i korespondon ofertës me vlerë 27,320,000 (njezetë e shtatë milion e treqinde njezetë mije) Leke (pa TVSH); Aktualisht në llogarinë tonë, në dokumentet e ofertës të hedhura në SPE për offer-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të Burgjeve), gjendet i pasqyruar, dokumenti i emërtuar në SPE oferta burgjeve FINALE 10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf me madhësi të dokumentit të ofertës ekonomike finale 303.9 kb (e njëjtë me madhësinë e dokumentit oferta burgjeve finale, të ruajtur nga ana jonë në folderin e kësaj procedure*

*prokurimi) në të cilin pasqyrohet fakti se ky dokument është hedhur dhe ruajtur në SPE në datën 20.03.2024, ora 10:56, në SPE, fakt që vërteton të gjitha veprimet tona të kryera në SPE e të shpjeguara më sipër. Në listën e dokumenteve të dorëzuara të ofertës tonë për këtë procedurë prokurimi (pasqyruar kjo listën e dokumenteve të dorëzuara në mësazhin e mësipërm) rezulton të jetë dorëzuar dokumenti më PDF me emërtimin e ofertës ekonomike e cila është edhe oferta ekonomike finale, e hedhur përfundimisht nga ana jonë në orën 10:56, e që i korespondon ofertës me vlerë 27,320,000 (njezetë e shtatë milion e treqinde njezetë mije) Leke (pa TVSH). Të gjitha mesazhet e mësipërme do t'i gjeni në formatin print screen në dokumentin bashklidhur kësaj ankese elektronike. Sa më sipër shpjeguam, nga ana e shoqërisë tonë janë kryer të gjitha veprimet në SPE, në përputhje të plotë me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik të APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021 për miratimin e Manualit për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë, rrjedhimisht nuk mund të penalizohemi duke u skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për shkak se, sistemi elektronik i prokurimeve nuk ka funksionuar, apo sepse KVO ne kundershtim me ligjin ka skualifikuar ofertën tonë me një arsye skualifikimi që nuk qëndron.*

*SË DYTI: Shoqëria Euro Mega 2010 SHPK deri në momentin që morëm dijeni në lidhje me arsyen e skuafikimit, nuk kishte asnjë arsye të dyshontë se, sistemi i prokurimit publik ndoshta nuk ka funksionuar në lidhje me ndryshimet e bëra në ofertën e saj për procedurën e prokurimit objket i këtij ankimi.*
*Nisur arsyeja e skualifikimit të shoqërisë tonë dhe nga fakti se,*
*- Teknikisht vetë sistemi nuk të lejon të ngarkosh dy dokumenta në seksionin e oferës ekonomike. Pra është e pamundur të jenë dy dokumenta në këtë seksion pra dy oferta ekonomike.*
*- fakti se, oferta ekonomike e hedhur në SPE në dritaren e katërt seksioni oferta Ekonomike, te paneli formulari i ofertësë, ku ngarkohet vetëm oferta ekonomike, enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit dhe nuk është e lexueshme nga ana jonë nëse futemi në llogarinë tonë në SPE për këtë procedurë prokurimi, më datë 08.04.2024, i jemi drejtuar KVO-së në agjencinë shtetërore të prokurimeve të përqendruara, me shkresën me lëndë: Kërkesë për informacion në lidhje me ofertën e dorëzuar për procedurën e prokurimit me objekt: Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të burgjeveë, me REF-96420-02-26-2024, të na vërë në dispozicion sa me parë të jetë e mundur, kopjet e vërtetuara të dokumenteve ku janë pasqyruar 2(dy) ofertat ekonomike të deklaruara nga ana e tyre se janë hedhuar në SPE nga shoqëria Euro Mega 2010 SHPK, për procedurën e prokurimit me objekt: Blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të burgjeve, me REF-96420-02-26-2024, të zhvilluar më datë 20.03.2024. Në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e LPP-së e konkretisht, me qëllimet e përcaktuara në germën d) dhe dh) të nenit 2 të tij si, sigurimi i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit public, sigururimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit public si dhe me parimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe detyrimi për të vepruar me transparencë e në mënyrë proporcionale (pika 1 e nenit 3 të*

*LPP-së) KVO në autoritetin kontraktor më datë 16.04.2024, jemi njohur në SPE, me përgjigjen e autoritetit kontrator ne lidhje me kërkesën tonë, me përmbajtjen si më poshtë: Në lidhje me shkresën tuaj kërkesë për informacion në lidhje me ofertën për procedurën e prokurimit blerje detergjent për drejtorinë e përgjithshme të burgjeve. Me fond të përgjithshëm: 39,951,333. REF-96420-02-26-2024, ju sqarojmë se: Në mbështetje të Nenit 81, pika 1 e drejta për informimë dhe Nenin 99 të LPP, Autoriteti Kontraktor ka shpallur në Sistemin e Prokurimit Elektronik të gjithë infomacionin që legjislacioni parashikon për operatorët pjesëmarrës pas fazës së klasifikimit të ofertave. Për sa i përket 2 (dy) ofertave ekonomike që keni ngarkuar në sistemin elektronik, vlersojmë se, ato disponohen nga ana juaj, pasi janë hartuar, vulosur dhe nënshkruar nga vetë operatori ekonomik. Në vlerësimin tonë KVO-ja në autoritetin kontraktor ka shkelur ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi përpara se, të merrte vendimin për skualifikimin e ofertës tonë me arsyen se, shoqëria jonë ka dorëzuar ne SPE, 2 oferta, në zbatim të nenit 3 të LPP-së, të manualit teknik të APP-së për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronikeë, të miratuar me udhëzimin e APP-së Nr. 07, datë 30.07.2021, në faqen 86 dhe 87 të tij, në mënyrë të qartë është përcaktuar:*
*Kujdes: Te paneli formulari i ofertës, ngarkohet vetëm një dokument, e cila enkriptohet duke mundësuar një ruajtje të informacionit të hedhur në sistem deri në hapjen e ofertave. Emërtimi i dokumenteve të bashkëlidhur në këtë skedar do të marrë si prapashtesë një numër nga sistemi. Në rast se, shfaqet një error gjatë procesit të hapjes së ofertës si dhe kur oferta ekonomike iu shfaqet e enkriptuar anëtarëve të Komisionit të vlerësimit të Ofertave, atëherë autoriteti/enti kontraktor duhet të dërgojë në agjencinë e Prokurimit Publik një kërkesë zyrtare, ku të saktësohet objekti i procedurës dhe numri i referencës në sistem, në mënyrë që të bëhen verifikimet e duhura për errorin e shfaqur si dhe të bëhet i mundur procesi i dekriptimit për ofertën ekonomike të dorëzuar nga operatori ekonomik. Bazuar në manualin e APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021, në faqet 23 dhe 24 dhe 26 të tij përcaktohet ku përcaktohet: Në dritaren e katërt seksioni oferta ekonomike, operatori ekonomik duhet të ngarkojë vetëm ofertën ekonomike, e cila enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit... Ky dokument, pasi ngarkohet në sistem enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit por në datën e hapjes së procedurës nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave do bëhet e lexueshme... KUJDES: NËSE TENTONI TË SHTONI NJË DOKUMENT TJETËR NË KËTË SEKSION, SISTEMI NUK DO JU LEJOJË... Në këtë rast, ju duhet të bëni në fillim fshirjen e dokumentit të ofertës së parë të bashkangjitur në sistem me anë të butonit fshi dokument dhe pasi të keni ruajtur veprimet tuaja, mund të bashkangjitni një dokument tjetër në këtë seksion me anë të butonit shto dokument. Pasi të keni përfunduar me bashkëlidhjen e të gjithë dokumenteve, pjesë e ofertës tuaj për këtë procedurë prokurimi, klikoni butoni hapi tjetër dhe zgjidhni opsionin e përfunduar për të dorëzuar ofertën tuaj pranë autoritetit kontraktor dhe më pas klikoni butonin hapi tjetër. Në këtë moment, oferta juaj do të kalojë te skedari tenderat e mi oferta të dorëzuara. Kujdes: Të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, kanë të drejtë të heqin, të bashkëlidhin dokumente të reja në procedurat e prokurimit apo të tërheqin të gjithë ofertën, deri në datën dhe orën e përcaktuar në sistem si afati i fundit për pranimin e ofertave nga autoritetet kontraktore. KVO në autoritetin kontraktor, duhet ti ishte drejtuar agjencisë së*

*prokurimit publik për të sqaruar këtë anomali të sistemit, pasi sikurse ne jemi në dijeni se sistemi nuk të lejon të ngarkosh dy dokumenta në seksionin e ofertës ekonomike, për më tepër zyrtarët e ASHPP-së, si një strukturë e specializuar për prokurimet sigurisht janë të detyruar të jenë në dijeni të këtij fakti. Shoqëria jonë ka qënë prezent në dorëzimin e mostrave dhe hapjen e ofertave ekonomike dhe nga ana e zyrtarëve të KVO-së është lexuar vetëm oferta jonë e ndryshuar e konkretisht me vlerën 27,320,000 (njezetë e shtatë milion e treqind e njezetë mije) Leke (pa TVSH) dhe nuk është vënë në dukje se, shoqëria Euro Mega 2010 SHPK ka ofertuar me dy oferta ekonomike me vlera të ndryshme. KVO duhet ti kërkonte sqarime operatorit tonë ekonomik në lidhje me sa më sipër, por KVO në shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik ka nxituar të skualifikojë ofertën e shoqërisë tonë dhe të kualifikojë e të shpallë paraprakisht fitues ofertën e operatori ekonomik Malvina Visoka P.F, me një ofertë me vlerë të ofertuar: 33,750,000 (tridhjetë e tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH e cila është 6,430,000 lekë me e lartë se oferta e shoqërisë Euro MEGA 2010 SHPK, duke i shkaktuar një dëm të konsiderueshëm buxhetit të shtetit dhe duke e favorizuar në këtë kompani në kundërshtim me ligjin. Sikurse e cituam edhe më lartë tek rrethanat e fakteve, në mungesë të transparencës së autoritetit kontraktor, ju drejtuam edhe agjencisë së prokurimit publik, për të marrë jo vetëm informacion por, edhe këshillë ligjore dhe teknike se si duhet të veprojë autoriteti kontraktor dhe shoqëria jonë dhe cila është oferta e cila duhet të merret në konsideratë për këtë procedurë prokurimi në rast se, në SPE realisht janë 2 oferta ekonomike, pra në rast se, sistemi elektronik i prokurimeve nuk ka funksionuar, pra nuk i ka pasqyruar ndryshimet e bëra në ofertë nga ana e shoqërisë tonë, për periudhën nga data 19.03.2024, ora 14:25 deri më datën 20.03.2024, ora 11:00, në lidhje me offer-8040/11032024. Për qartësimin e fakteve, në kushtet kur deri në këtë moment, ende nuk kemi një përgjigje të plotë nga Agjencia e Prokurimit Publik, por vetëm një konfirmim me email të datës 18.04.2024, ku nga Agjencia e Prokurimit Publik, në përgjigje të kërkesës tonë të datës 12.04.2024, në emailin zyrtar të shoqërisë, bëhemi me dije se, ..Shkresa juaj eshte depozituar prane APP dhe po trajtohet. Sapo te kemi nje pergjigje do t'ju dergohet ne rruge zyrtare.., kërkojmë që ti kërkohet APP-së nga ana e autoritetit kontraktor ose / dhe KPP-ja që:*

*- Të konfirmoj referuar të dhënave të cilat ruhen dhe administrohen në SPE, të gjitha veprimet e kryera nga ana e shoqërisë Euro MEGA 2010 SHPK me NIPT/NUIS K91624505A në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për periudhën nga data 19.03.2024, ora 14:25 deri më datën 20.03.2024, ora 11:00, në lidhje me offer-8040/11032024 për procedurën e prokurimit blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të burgjeve, me REF-96420-02-26-2024; - Në zbatim të pikës 41 të nenit 4 dhe gërmës f) të nenit 23 të LPP-së, si institucioni i cili administron të dhënat e Sistemit të Prokurimit Elektronik, të konfirmojë, nëse realisht në SPE ekzistojnë 2 (dy) oferta ekonomike, tek skedari formulari i ofertësë, ku është pasqyruar oferta ekonomike e deklaruar nga ana jonë për procedurën e prokurimit me objekt: blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të burgjeve, me REF-96420-02-26-2024, të zhvilluar më datë 20.03.2024 me offer-8040/11032024, se nga ana e operatorit tonë ekonomik të gjitha veprimet e kryera në SPE janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik të APP-së për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronikë të miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 datë 28.12.2021. Jemi të gatshëm dhe jemi në dispozicionin tuaj, nëse vlerësoni se mund tju vimë në ndihmë, për*

*sqarimin e fakteve dhe rrethanave apo për marrjen e një vendimi të drejtë dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Pra sa më sipër kërkojmë shfuqizimin e vendimit të KVO -së në lidhje me skualifikimin e ofertës të kompanisë Euro MEGA 2010 SHPK, duke vendosur kualifikimin e ofertës për procedurën e prokurimit me objekt blerje detergjentë për drejtorinë e përgjithshme të burgjeveë, me REF-96420-02-26-2024.*

*II. Në lidhje me kërkesën tonë për skualifikimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit Malvina Visoka PF dhe An&Ra shpk paraqesim kndërshtimet tona si më poshtë:*
*SË PARI: Shoqëria Euro MEGA 2010 SHPK, është një shoqëri e cila ka që prej vitit 2009 që ushtron aktivitetin e saj në fushën e prodhimit dhe tregëtimit të detergjentëve dhe si e tillë e njeh shumë mirë tregun në këtë fushë si dhe njeh mirë konkurentët e saj. Nisur nga ky fakt, por edhe nga veprimet e autoritetit kontraktor, që në vlerësimin tonë janë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe në shkelje të qëllimeve dhe parimeve të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, ne besojmë se ofertuesit Malvina Visoka PF dhe An&Ra shpk, nuk i kanë plotësuar kriteret për kualifikim si dhe produktet e tyre nuk i plotësojnë specifikimet teknike të përcaktura në shtojcën 5 të DT-së. Konkretisht ne besojmë se, nga ana e të dy ofertuesve nuk janë plotësur kriteret e mëposhtme për kualifikim: 5.Operatori ekonomik per produktet objekt prokurimi diten e hapjes se ofertave duhet te paraqes mostrat te cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST, si dhe skeden teknike te prodhuesit në gjuhën shqipe (e përkthyer e noterizuar nëse është në gjuhë huaj)... 6. Operatori ekonomik per secilen nga produket do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar ose i Certifikuar kombetar/nderkombetar të lëshuara brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, duhet të paraqitet origjinale, ose fotokopje të noterizuara. 7.Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i ketyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose kontratë Funizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet të permbaje të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit te autorizuar.. Në këtë procedurë prokurimi të dy kompanitë kanë ofertuar si tregëtues, me produkte të të njëjtit prodhues, për të cilat janë pasjiur më autorizime nga e njëjta kompani e konkretisht Anhel SHPK; në cilësine e një kompanie e cila është distributore e autorizuar e një kompanie turke. Në këto rrethana kemi të drejtë të besojmë se, ofertuesit Malvina Visoka PF dhe An&Ra SHPK edhe pse kanë firmosur shtojcën 8 (FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT), pra edhe deklaratën për dorëzimin e Ofertave të pavarura, pikën 6/a) të saj ku deklarohet se, ...Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër, si dhe deklarimet sipas pikave 7 , 8 dhe 9 të këtij formulari, ofertimi me të njejtin produkt dhe të autorizuar nga e njëjta kompani, sjell një ofertim i cili nuk është i pavarur, pasi shoqëritë minimalisht janë marrë vesh për cmimet me të cilat kanë ofertuar. Diferenca e vogël në cmim e provon këtë fakt.*

*SË DYTI: Në një mënyrë haptazi në shkelje të rregullave të prokurimit publik, në kundërshtim me qëllimin dhe parimet e ligjit 162/2020, njësia e prokurimit në autoritetin kontraktor vetëm*

*një ditë përpara hapjes së ofertave ka ndryshuar kriteret për kualifikim nisur nga kërkesa e njërit prej ofertuesve, e konkretisht: Tek Shtojca 7 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/kualifikimit.*

*ISHTE 6. Operatori ekonomik per secilen nga produket do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar kombetar/nderkombetar e cila të jetë e lëshuar brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, nga data e hapjes së ofertave, duhet të paraqitet origjinale, ose fotokopje të noterizuara.*

*BËHET 6. Operatori ekonomik per secilen nga produket do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar ose i Certifikuar kombetar/nderkombetar të lëshuara brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, duhet të paraqitet origjinale, ose fotokopje të noterizuaraë. Autoriteti kontraktor vendos për pasojë edhe shtyrjen e Afatit të fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave duke e vendosur atë në datë: 20.03.2024 Ora:11:00.*

*Ky ndryshim shkel hapur parimet e LPP-së të përcaktuara në nenin 3 të tij e konkretisht:*
*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparenc e në mënyrë proporcionale.*
*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuarë. Ndryshimi i kriterit vetëm një ditë përpra hapjes së ofertave dukshëm ka favorizuar operatorë të caktuar, në raport me ofertuesit e tjerë, duke ndryshuar rregullat e konkurimit, pasi në kushtet kur në shqipëri nuk ka laboratorë të akreditur për detergjentët, shoqëria jonë ka bërë shpenzime të konsiderueshmë duke i kryer ananlizat në laboratorë të akreditur jashtë vendit, ndërkohë AK-ja plotëson kërkesën e njërit prej ofertuesve dhe mundëson pranimin e analizave të realizuara edhe nga nje organ/institucion i Certifikuar kombetar/nderkombetar.*

*Sa më sipër ne besojmë se, ofertuesit Malvina Visoka PF dhe An&Ra SHPK pavarësisht favorizimit të bërë nga AK-ja, sërisht nuk kanë arritur të paraqesin fletë analiza të lëshuara nga nga nje organ/institucion i akredituar ose i Certifikuar kombetar/nderkombetar të lëshuara brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, të cilat duhet të jenë origjinale, ose fotokopje të noterizuara, ku të vërtetohet se produktet me të cilat kanë ofertuar i plotësojnë të gjitha prametrat e përcaktuara për të 3 produktet në shtojcën 5 të dt-së e konkretisht në lidhje me: <u>Densitetin e kërkuar, Vlera e ph, tretshmëria në ujë, lagështisë, përmbajtja e lëndëve tensioaktive, p</u>ërmbajtja e perboratit dh lartësinë e shkumës.*

*Fletë analizat e dorëzuara prej tyre si pjesë e ofertave të tyre nuk janë të lëshuara nga laboratorë të akreditur apo edhe nga organe të cilat ligji ua jep të drejtën për të kryer analiza të detrgjententëve. Ligji i prokurimit publik njeh vetëm konceptin e laboratorëve të cilët duhet të jenë të akreditur sipas ligjit, dhe në thelb termi organ/institucion i Certifikuar kombetar/nderkombetarë sërisht të drejton vetëm tek laboratorët e akreditur për detergjentët sipas ligjit. Nga ana tjetë ne pretendojmë se, mostrat e dorëzuara nuk i plotësojnë specifikimet*

*teknike. Për gjithë sa më sipër, kërkojmë skualifikimin e ofertave të dorëzuara nga ofertuesit Malvina Visokaë PF dhe An&Ra SHPK, si oferta të cilat nuk i plotësojnë të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktura nga autoriteti kontraktor dhe për pasojë në zbatim të pikës 3 të nenit 92 të LPP-së ku përcaktohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Duke shpresuar në një vlerësim të drejtë, objektiv, profesional nga na juaj dhe në përputhje me qëllimet dhe parimet e ligjit të prokurimit public, kërkojmë pranimin e plotë të ankesës tonë.*

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 971/2 prot., datë 23.04.2024, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 971/2024 prot, datë 22.04.2024, si dhe kriteret të cilat operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik "*Malvina Visoka*" PF dhe operatori ekonomik "*AN&RA*" SHPK.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se me shkresën nr. 971/3, datë 30.04.2024, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga operatori ekonomik i interesuar "*Malvina Vispoka*" PF, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit Nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*".

II.9. Me shkresën nr. 971/4 prot, datë 02.05.2024 pranë Komisionit Prolurimit Publik është protokolluar shkresa "*Kërkesë për Informacion në lidhje me ofertën e dorëzuar drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik*" e operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 69/2 prot., datë 02.05.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 971/5 prot., datë 08.05.2024, me objekt "*Dërgohet vendim mbi ankesën" bashkalidhur të cilës ndodhet akti trajtimit të ankesës Vendimi nr. 69/1 prot, datë 30.04.2024"*, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës si më poshtë vijon:

*Operatori Ekonomik, pretendimet si vijon: "Euro Mega 2010" SHPK ka ankimuar vendimin e KVO, ne lidhje me arsyet e skualifikimit te ofertes se shoqerie EURO MEGA 2010 SHPK, si me poshte: Operatori ekonomik Euro Mega 2010 SHPK nuk ploteson kerkesen ne DST per numrin e oferave te lejuara ne proceduren e prokurimit nga nje ofertues pasi rezulton se, ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Konkrestisht EURO MEGA 2010, ka ngarkuar ne spe dy oferta ekonomike. Konkretisht EURO MEGA 2010, ka ngarkuar ne SPE dy oferta ne vlerat: oferta 1- 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke paTVSH (me numra dhe fjale) dhe oferta 2- 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqinde njezete mije) Leke pa TVSH (me numra dhe fjale). Referuar DST Seksioni i Pergjithshem ne kete procedure*

*nuk lejohet me shume se 1 oferte ose oferte alternative. Ne zbatim te pikes 4 te nenit 79 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 Për Miratimin e rregullave te prokurimit publik operatoret ekonomike duhet te paraqesin vetem nje ofert, me perjashtim te rasteve kur kerkohen oferta alternative dhe per kete arsye subjekti EURO MEGA 2010 SHPK skualifikohet nga renditja ne kete procedure dhe ofertat refuzohen paraqesim kudershtimet tona si me poshte:*

*SE PARI: Shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK, ka hartuar dhe ka ngarkuar ne sistemin elektronik të prokurimeve te gjitha dokumentet e saj te ofertes ne perputhje te plote me ligjin, rregullat e prokurimit publik dhe me manualet e Agjencise se Prokurimit Publik. Konkretisht legjslacioni i prokurimeve parashikon: Në nenin 4 (Perkufizime) te ligjit nr 162, date 23.12.2020 Per prokurimin publik percaktohet: Per qellim te ketij ligji, termat e meposhtem kane keto kuptime:*

*29. Mjet elektronik eshte pajisje elektronike per perpunimin dhe ruajtjen e te dhenave (perfshire këtu edhe perpunimin digjital) qe transmetohen, jepen e merren permes kabllove, radios, mjeteve optike ose cdo mjeti tjeter elektromagnetik.*

*41. Sistem i prokurimit elektronik eshte nje baze te dhenash shteterore, e krijuar sipas legislacionit ne fuqie qe perdoret per kryerjen e procedurave te prokurimit publik dhe administrohet nga Agjencia e Prokurimit Publik. Ne nenin 17 (Forma e komunikimit), te ligjit nr 162, date 23.12.2020 Per prokurimin publik percaktohet: 1. I gjithe komunikimi dhe shkembimi i informacionit ne zbatim te ketij ligji kryhen duke perdorur mjetet elektronike te komunikimit. Perjashtimisht, komunikimi dhe shkembimi i informacionit mund te kryhen ne forme shkresore, sipas parashikimeve ne rregullat e prokurimit publik. Rastet kur mund te perdoret komunikimi ne rruge shkresore percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave. Pa cenuar parimin e pergjithshem te mosdiskriminimit dhe parashikimet e ketij ligji, rregullat e mëposhtme jane te zbatueshme per marrjen e ofertave dhe kerkesave per pjesemarrje nepermjet mjeteve te transmetimit elektronik si me poshte: informacionet qe lidhen me specifikimet e nevojshme per paraqitjen elektronike te ofertave dhe kerkesave per pjesemarrje, perfshire enkriptimin, duhet të jene ne dispozicion te palëve te mjetet per marrjen elektronike te ofertave dhe kerkesave per pjesemarrie duhet te jene ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne regullat e prokurimit publik dhe me legjslacionin perkates. Ne rastet kur autoriteti ose enti kontraktor komunikon ne forme elektronike, mjetet e komunikimit elektronik dhe karakteristikat e tyre teknike duhet te jene jodiskriminuese, te disponueshme dhe te nderoperueshme me produkte te teknologjise se informacionit dhe te komunikimit, te cilat perdoren gjeresisht. Rregullat dhe procedurat per kete forme komunikimi percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave. Komunikimi, shkembimi dhe ruajtja e informacionit kryhen ne nje menyre te tille qe te sigurojne ruajtjen e integritetit te te dhenave, konfidencialitetin e ofertave dhe te kerkesave për pjesemarrje. Forma e perdorur per komunikim, shkembim dhe ruajtjen e informacionit duhet te garantoje se autoriteti ose enti kontraktor mund te shqyrtoje permbajtjen e ofertave dhe te kerkesave per pjesemarre, vetem pasi te kete perfunduar afati kohor ligjor per dorezimin e tyre, i percaktuar nga ky ligi. Sa me siper cituam, menyra e ofertimit nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimeve nga ana e operatoreve ekonomike eshte e percaktuar qarte ne aktet ligjore, nenligjore si dhe në manualet teknike te hartuara e miratuara nga Agencia e Prokurimit Publik, dhe referuar pikerisht ketyre manualeve, teknikisht operatori ekonomik nuk mund te ngarkoje tek paneli Formulari i Ofertes me teper se*

*nje dokument, pra teknikisht sistemi nuk te lejon te ngarkosh dy dokumenta, te cilat referuar rregullave teknike duhet te jene ne formatin PDF, ku te jene pasqyruar shtojcat Shtojca 1 (Formulari i Ofertes) dhe Shtojca 2 (Listat e cmimeve te artikujve), pra oferta ekonomike. Ne manualin e APP-se Per regjistrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik te miratuar me vendimin e APP-se Nr. 13 date 28.12.2021, ne faqen 26 te tij percaktohet: Kujdes: Te gjithe operatorët ekonomike te cilët ofertojne ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, kane te drejte te heqin, te bashkëlidhin dokumente te reja ne procedurat e prokurimit apo dhe terheqin te gjithe oferten, deri ne daten dhe orën e percaktuar ne sistem si afati i fundit per pranimin e ofertave nga autoritetet kontraktore. Nga ana e shoqerise Euro Mega 2010 SHPK, perpara ores 11:00 qe ishte dhe afati 1 i fundit per pranimin e ofertave, e konkretisht ne orën 10:56, eshte bere nje ndryshim ne ofertën e dorezuar e cila ishte ne statutusin e perfunduar, duke respektuar rigorozisht Manulin teknik te APP-se. Konkretisht: Shoqeria Euro Mega 2010 SHPK, ofertën ekonomike si shtojcën 1 dhe shtojcen 2 te DT-s i ka hedhur ne nje dokument te vetem ne formatin e kerkuar pdf, vetem ne këte dritare, pra jo ne driteret e tjera. Me date 19.03.2024, ora 14:28, shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK, ka perfunduar hedhjen e te dhenave ne llogarine e saj ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, vërtetuar ky fakt me mesazhin e ardhur ne SPE, ne këte ore dhe ne këte date. Tek dritarja Formulari i Ofertës, tek skedari bashkëngjitur eshte ngakuar dokumenti ne PDF i emertuar Oferta ekonomike i cili pasi eshte hedhur ne SPE eshte inkriptuar me te dhenat: Oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-bld2-dOc8f25d9d7a.pdf. Ne kete dokument jane perfshire dhe gjenden Shtoja 1. Formulari i Ofertës dhe Shtojca 2. Listat e cmimeve te artikujve, pra oferta ekonomike e cila ne kete moment eshte ofertuar nga ana e shoqerise tone ne vlerën 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke pa TVSH. Oferta ka marre numrin ne SPE OFFER-8040/11032024. I njejti emertim ne lidhje me oferten ekonomike rezulton te pasqyrohet edhe ne mesazhin e ardhur tek rubrika Mesazhe, ne logarine tone ne SPE, ku eshte konfirmuar fakti se, oferta jone OFFER-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergente per Drejtorine e Përgjithshme te Burgjeve) u dorezua. Ne këte mesazh, ne listen e dokumenteve te ofertes, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar Oferta ekonomike_ 6507b83a-51a8-461f-bld2-dOc8/25d9d7a.pdf Me date 20.03.2024, perpara perfundimit te afatit per dorezimin e ofertave per kete procedure prokurimi, shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK, vendosi te ndryshoje vleren e ofertes ekonomike te ofertuar per kete procedure. Pasi u kryen nga ana e shoqerise tone te gjitha veprimet ne SPE, në perputhje te plote me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik te APP-se Per regjistrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik te miratuar me vendimin e APP-se Nr. 13 date 28.12.2021 Per miratimin e Manualit per regjistrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik, ky ndryshim u pasqyrua ne SPE me date 20.03.2024 ora 10:56. Konkretisht, tek dritarja Formulari i Ofertës, tek skedari bashkëngjitur eshte ngarkuar dokumenti ne PDF i emertuar oferta ekonomike finale i cili pasi eshte hedhur ne SPE eshte inkriptuar me te dhenat: oferta burgjeve FINALE:10421f09-8918-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf. Në kete dokument jane perfshire dhe gjenden Shtojca 1. Formulari i Ofertës dhe Shtojca 2. Listat e cmimeve te artikujve, pra oferta ekonomike e ndryshuar, me vlere totale 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqinde njezete mije) Leke (pa TVSH). Më date*

*20.03.2024, ora 10:56, nepermjet mesazhit te ardhur tek rubrika Mesazhe, ne llogarine tone ne SPE, eshte konfirmuar fakti se, oferta jone OFFER-8040/11032024, per tenderin REF-96420-02- 26-2024 (Blerje Detergente per Dreitorine e Pergjithshme te Burgjeve) u dorezua. Në kete mesazh, ne listën e dokumenteve te ofertes, rezulton e listuar dokumenti i emertuar oferta burgjeve FINALE_10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81bOdfb83bd9.pdf. Më date 20.03.2024, ora 11.00, ka perfunduar afati per dorezimin e ofertave per proceduren me te dhenat e mesiperme, per te cilen shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK sic shpjeguam me lart dorezoi ofertën e saj.*
*Shoqeria Euro Mega 2010 SHPK, ka ne Ilogarine e saj ne SPE, te giitha mesazhet elektronike qe vertetojne te gjitha veprimet e kryera nga ana jone ne lidhje me ndyshimet ne oferten tone, jane bere konform rregullave e dokumentuar si me poshte: Mesazhi ne SPE i ores 19.03.2024 ora 14:28 (mesazhi i cili verteton se, oferta jone OFFER-8040/11032024, per tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergjente për Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve) u dorezua. Ne kete mesazh, ne listën e dokumenteve te ofertes, rezulton e listuar dokumenti i emërtuar Oferta ekonomike 6507683-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf me vlere: 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gashteqinde pesedhjete e pese mije) Leke pa TVSH. Oferta ka marre numrin ne SPE OFFER-8040/11032024. Mesazhi ne SPE i datës 20.03.2024 ora 10:56, vertetohet dhe konfirmohet fakti se, jane fshire dokument nga oferta e konkretisht eshte fshire dokumenti: Oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-bld2-dOc8f25d9d7a.pdf, Mesazhi ne SPE i dates 20.03.2024 ora 10:56, mesazh i cili provon dhe konfirmon se oferta OFFER-8040/11032024, për tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve), ka marre statusin e paperfunduar, Mesazhi ne SPE i dates 20.03.2024, ora 10:56, i cili provon dhe konfirmon se, oferta jone OFFER-8040/11032024, per tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergjente per Dretorine e Pergjithshme te Burgjeve) u dorezua. Ne kete mesazh, ne listen e dokumenteve te ofertes, rezulton e listuar dokumenti i emertuar oferta burgeve FINALE_10421/09-89/8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf, qe i korespondon ofertes me vlere 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqinde njezete mije) Leke pa TVSH; Aktualisht ne llogarine tone, ne dokumentet e ofertes te hedhura në SPE per OFFER-8040/11032024, per tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve), gjendet i pasqyruar, dokumenti i emertuar ne SPE oferta_burgjeve_FINALE_10421 f09-89f8-4a5f- ad2b-81bOdfb83bd9.pdf, me madhesi te dokumentit te ofertes ekonomike finale 303.9 kb (e njejte me madhesine e dokumentit oferta burgieve FINALE, te ruajtur nga ana jone ne folderin e kesaj procedure prokurimi) ne te cilin pasqyrohet fakti se ky dokument eshte hedhur dhe ruajtur ne SPE ne datën 20.03.2024, ora 10:56, ne SPE, fakt qe verteton te githa veprimet tona te kryera ne SPE e te shpjeguara me siper. Ne listen e dokumenteve te dorezuara te ofertes tone per kete procedure prokurimi (pasqyruar kjo listen e dokumenteve te dorezuara ne mesazhin e mësiperm) rezulton te jete dorezuar dokumenti me PDF me emërtimin e ofertes ekonomike e cila eshte edhe oferta ekonomike finale, e hedhur perfundimisht nga ana jone ne orën 10:56, e qe i korespondon ofertes me vlere 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqinde njezete mije) Leke pa TVSH. Te giitha mesazhet e mësiperme do ti gjeni ne formatin print screen ne dokumentin bashklidhur kësaj ankese elektronike. Sa me siper shpjeguam, nga ana e shoqerise tone jane kryer te gjitha veprimet ne SPE, ne perputhje te plote me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik te APP-se Per regjistrimin e operatoreve ekonomike*

*dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik te miratuar me vendimin e APP-se Nr. 13 date 28.12.2021 Per miratimin e Manualit per registrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik, rrjedhimisht nuk mund te penalizohemi duke u skualifikuar nga kjo procedure prokurimi per shkak se, sistemi elektronik i prokurimeve nuk ka funksionuar, apo sepse KVO ne kundershtim me ligjin ka skualifikuar ofertën tone me nje arsye skualifikimi qe nuk qendron.*

*Shoqria Euro Mega 2010 SHPK deri ne momentin qe morem dijeni ne lidhje me arsyen e skuafikimit, nuk kishte asje arsye te dyshonte se, sistemi i prokurimit publik ndoshta nuk ka funksionuar ne lidhje me ndryshimet e bera ne oferten e saj per proceduren e prokurimit objekt i ketij ankimi. Nisur arsyeja e skualifikimit te shoqerise tone dhe nga fakti se, teknikisht vete sistemi nuk te lejon te ngarkosh dy dokumenta ne seksionin e ofertes ekonomike. Pra eshte e pamundur te jene dy dokumenta ne këte seksion pra dy oferta ekonomike. - fakti se, oferta ekonomike e hedhur në SPE ne dritaren e katërt seksioni Oferta Ekonomike, te paneli Formulari i Ofertës, ku ngarkohet vetem oferta ekonomike, enkriptohet per efekt sigurie dhe ruajtjes se informacionit dhe nuk eshte e lexueshme nga ana jone nese futemi ne llogarine tone dhe SPE per këte procedure prokurimi; më date 08.04.2024, i jemi drejtuar KVO-së ne Agjencine Shteterore te Prokurimeve te Perqendruara, me shkresën me lënde: Kerkese per informacion ne lidhje me oferten e dorezuar per proceduren e prokurimit me objekt: Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve, me REF-96420- 02-26-2024, te na vëre ne dispozicion sa me pare te jete e mundur, kopjet e vertetuara te dokumenteve ku jane pasqyruar 2(dy) ofertat ekonomike te deklaruara nga ana e tyre se jane hedhuar ne SPE nga shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK, per proceduren e prokurimit me objekt: Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve, me REF-96420-02-26-2024, te zhvilluar me date 20.03.2024. Në kundershtim me qellimet dhe parimet e LPP-së e konkretisht, me qellimet e percaktuara ne germën d) dhe dh) te nenit 2 te tij si, sigurimi i nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik, sigururimi i integritetit, besimit publik dhe transparences ne procedurat e prokurimit publik si dhe me parimin e trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe detyrimi per te vepruar me transparence e ne mënyre proporcionale (pika 1 e nenit 3 te LPP-se) KVO ne autoritetin kontraktor me date 16.04.2024, jemi njohur ne SPE, me pergjigen e autoritetit kontrator ne lidhje me kerkesen tone, me permbajtjen si me poshte: Ne lidhje me shkresen tuaj Kerkes per informacion ne lidhje me oferten per proceduren e prokurimit Blerje detergjent per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve. me fond te pergjithshem: 39,951,333. REF-96420-02-26-2024, ju sqarojme se: Ne mbeshtetje te Nenit 81, pika 1 E drejta per informim dhe Nenin 99 te LPP, Autoriteti Kontraktor ka shpallur ne Sistemin e Prokurimit Elektronik te gjithe infomacionin qe legjslacioni parashikon per operatorët pjesemarres pas fazes se klasifikimit te ofertave. Per sa i perket 2 (dy) ofertave ekonomike qe keni ngarkuar ne sistemin elektronik, vleresojme se, ato disponohen nga ana juaj, pasi jane hartuar, vulosur dhe nënshkruar nga vete operatori ekonomik. Në vlersimin tone KVO-ja ne autoritetin kontraktor ka shkelur ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi perpara se, te merrte vendimin per skualifikimin e ofertes tone me arsyen se, shoqeria jone ka dorezuar ne SPE, 2 oferta, në zbatim te nenit 3 te LPP-se, te manualit teknik te APP-se Për mënyren e zhvillimit te procedurave te prokurimit me mjete elektronike, te miratuar me*

*Udhezimin e APP-se Nr. 07, date 30.07.2021, ne faqen 86 dhe 87 te tij, ne menyre te qarte eshte percaktuar: Kujdes: Te paneli Formulari i Ofertes ngarkohet vetem nje dokument, e cila enkriptohet duke mundësuar nje ruajtje te informacionit te hedhur ne sistem deri ne hapjen e ofertave. Emërtimi i dokumenteve te bashkëlidhur ne kete skedar do te marre si prapashtese nje numer nga sistemi. Ne rast se, shfaqet nje error gjate procesit te hapjes se ofertes si dhe kur oferta ekonomike iu shfaqet e enkriptuar anëtareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave atehere autorteti/entikontraktor duhet te dergoje ne Agiencine e Prokurimit Publik nje kerkese zyrtare, ku te saktesohet objekti i procedures dhe numri i references ne sistem, ne mënyre qe te behen verifikimet dorezuar nga operatori ekonomik; e duhura per errorin e shfaqur si dhe te behet i mundur procesi i dekriptimit per oferten ekonomike te Bazuar ne manualin e APP-se Per regjistrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik te miratuar me vendimin e APP-s Nr. 13 date 28.12.2021, ne faqet 23 dhe 24 dhe 26 te tij percaktohet ku percaktohet: Në dritaren e katërt seksioni Oferta Ekonomike, operatori ekonomik duhet te ngarkoje vetem ofertën ekonomike, e cila enkriptohet per efekt sigurie dhe ruajtjes se informacioni.... Ky dokument, pasi ngarkohet ne sistem enkriptohet per efekt sigurie dhe ruajtjes se informacionit por ne daten e hapjes se procedures nga te gjithe anëtarët e komisionit te versimit te ofertave do behet e lexueshme... KUJDES: NESE TENTONI TË SHTONI NJË DOKUMENT TJETËR NE KËTE SEKSION, SISTEMI NUK DO JU LEJOJ... Ne kete rast, ju duhet te bëni ne fillim fshirjen e dokumentit te ofertes se pare te bashkangjitur ne nje dokument tjeter ne kete seksion me ane te butonit Shto dokument. Pasi te keni perfunduar me bashkëlidhjen e te gjithe dokumenteve, pjese e ofertes tuaj per kete procedure prokurimi, klikoni butoni Hapi tjeter dhe zgjidhni opsionin e perfunduar po per te dorezuar oferten tuaj prane autoritetit kontraktor dhe me pas klikoni butonin Hapi jeter. Ne kete moment, oferta juaj do te kaloje te skedari Tenderat e mi Oferta te dorezuara. Kujdes: Te gjithe operatorët ekonomike te cilet ofertojne ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, kane te drejte te heqin, te bashkelidhin dokumente te reja ne procedurat e prokurimit apo te terheqin te gjithe oferten, deri ne datën dhe orën e percaktuar ne sistem si Afati i fundit per pranimin e ofertave nga autoritetet kontraktore; KVO ne autoritetin kontraktor, duhet te ishte drejtuar Agjencise së Prokurimit Publik per te sqaruar kete anomali te sistemit, pasi sikurse ne jemi ne dijeni se sistemi nuk te lejon te ngarkosh dy dokumenta ne seksionin e ofertes ekonomike, per me teper zyrtaret e ASHPP-se, si nje strukture e specializuar per prokurimet sigurisht jane te detyruar te jene ne dijeni te ketij fakti. Shoqeria jone ka qene prezent ne dorezimin e mostrave dhe hapjen e ofertave ekonomike dhe nga ana e zyrtareve te KVO-se eshte lexuar vetem oferta jone e ndryshuar e konkretisht me vleren 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqind e njezete mije) Leke pa TVSH dhe nuk eshte vene ne dukje se, shoqeria Euro Mega 2010 SHPK ka ofertuar me dy oferta ekonomike me vlera te ndryshme. KVO duhet ti kerkonte sqarime operatorit tone ekonomik ne lidhje me sa me siper, por KVO ne shkelje te ligjit dhe rregullave te prokurimit publik ka nxituar te skualifikoje ofertën e shoqerise tone dhe te kualifikoje e te shpalle paraprakisht fitues ofertin e operatori ekonomik Malvina Visoka P.F, me nje oferte me vlere te ofertuar: 33,750,000 (tridhjete e tre milion e shtateqind e pesedhjete mije) leke pa TVSH e cila eshte 6,430,000 leke me e larte se oferta e shoqerise EURO MEGA 2010 SHPK, duke i shkaktuar nje dem te konsiderueshem buxhetit te shtetit dhe duke e favorizuar ne këte kompani në kundershtim me ligjin. Sikurse e cituam edhe me larte tek rrethanat e fakteve, ne*

*mungese te transparences se autoritetit kontraktor, ju drejtuam edhe Agencise se Prokurimit Publik, per te marre jo vetem informacion por, edhe keshille ligjore dhe teknike se si duhet te veproje autoriteti kontraktor dhe shoqeria jone dhe cila ishte oferta e cila duhet te merret ne konsiderate per kete procedure prokurimi ne rast se ne SPE realisht jane 2 oferta ekonomike, pra ne rast se, sistemi elektronik i prokurimeve nuk ka funksionuar, pra nuk i ka pasqyruar ndryshimet e bera ne oferte nga ana e shoqerise tone, për periudhen nga data 19.03.2024, ora 14:25 deri me datën 20.03.2024, ora 11:00, ne lidhje me OFFER-8040/11032024 . Per qartesimin e fakteve, ne kushtet kur deri ne kete moment, ende nuk kemi nje pergjigje te plote nga Agencia e Prokurimit Publik, por vetem nje konfirmim me email te dates 18.04.2024, ku nga Agencia e Prokurimit Publik, ne pergjigje te kerkeses tone te datës 12.04.2024, ne emailin zyrtar te shoqerise, behemi me dije se, ...Shkresa juaj eshte depozituar prane APP dhe po trajtohet. Sapo te kemi nje pergjigie do t'ju dergohet ne rruge zyrtare., kerkojme qe ti kerkohet APP-se nga ana e autoritetit kontraktor ose / dhe KPP-ja qe: Te konfirmoje referuar te dhenave te cilat ruhen dhe administrohen ne SPE, te gjitha veprimet e kryera nga ana e shoqërise EURO MEGA 2010 SHPK me NIPT/NUIS K91624505A ne Sistemin e Prokurimit Elektronik, per periudhen nga data 19.03.2024, ora 14:25 deri me datën 20.03.2024, ora 11:00, ne lidhje me OFFER-8040/11032024 per proceduren e prokurimit "Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve", me REF-96420-02-26-2024; Ne zbatim te pikes 41 te nenit 4 dhe gërmes f) te nenit 23 te LPP-se, si institucioni i cili administron te dhenat e Sistemit te Prokurimit Elektronik, te konfirmoje, nese realisht ne SPE ekzistone 2 (dy) oferta ekonomike, tek skedari Formulari i ofertes, ku eshte pasqyruar oferta ekonomike e deklaruar nga ana jone per proceduren e prokurimit me objekt: Bleje Detergjente per Drejtorine e Përgjithshme te Burgjeve, me REF-96420-02-26-2024, te zhvilluar me date 20.03.2024 me OFFER-8040/11032024, se nga ana e operatorit tone ekonomik te gjitha veprimet e kryera ne SPE jane ne perputhje me rregullat e prokurimit publik dhe me manualin teknik te APP-se Per registrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne sistemin e prokurimit elektronik te miratuar me vendimin e APP-së Nr. 13 date 28.12.2021. Jemi te gatshem dhe jemi ne dispozicionin tuaj, nese vlersoni se mund ju vime ne ndihme, per sqarimin e fakteve dhe rrethanave apo per marrjen e nje vendimi te drejte dhe ne perputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Kerkojme shfuqizimin e vendimit te KVO-se ne lidhje me skualifikimin e ofertes te kompanise EURO MEGA 2010 SHPK, duke vendosur kualifikimin e ofertes per proceduren e prokurimit me objekt Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve, me REF-96420-02-26-2024.*

*II. Ne lidhje me kerkesën tone per skualifikimin e ofertave te paraqitura nga ofertuesit Malvina Visoka PF dhe AN&RA SHPK paraqesim kundershtimet tona si me poshte:*

*SE PARI: Shoqeria EURO MEGA 2010 SHPK, eshte nje shoqeri e cila ka qe prej vitit 2009 qe ushtron aktivitetin e saj ne fushen e prodhimit dhe tregetimit te detergjenteve dhe si e tille e njeh shume mire tregun ne këte fushe si dhe njeh mire konkurentet e saj. Nisur nga ky fakt, por edhe nga veprimet e autoritetit kontraktor, qe ne vleresimin tone jane ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik dhe ne shkelje te qellimeve dhe parimeve te percaktuara ne ligjin per prokurimin publik, ne besojme se ofertuesit Malvina Visoka PF dhe AN&RA SHPK nuk i*

*kanë plotesuar kriteret per kualifikim si dhe produktet e tyre nuk i plotesone specifikimet teknike te percaktura ne shtojcën 5 te DT-së. Konkretisht ne besojme se, nga ana e te dy ofertuesve nuk jane plotesur kriteret e mëposhtme per kualifikim: 5. Operatori ekonomik per produktet objekt prokurimi diten e hapjes se ofertave duhet te paraqes mostrat te cilat duhet te jene ne perputhje me specifikimet teknike ne DST, si dhe skeden teknike te prodhuesit ne gjuhën shipe (e perkthyer e noterizuar nese eshte ne gjuhe huaj). 6. Operatori ekonomik per secilen nga produket do te paraqese flete-analize nga nje organ/institucion i akredituar ose i certifikuar kombetar/nderkombetar te leshuara brenda 60 (gjashtedhjete) diteve nga hapja e ofertave, duhet te paraqitet origjinale, ose fotokopje te noterizuara. 7. Operatori ekonomik duhet te deklaroje nëse eshte prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave per artikujt objekt prokurimi. Ne rast kur OE nuk eshte prodhues i ketyre produkteve/artikujve, ai duhet te disponoje dhe te paraqese: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontrate Funizimi/Bashkepunimi nga nje Distributor i autorizuar, ne te cilat duhet te jene percaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit apo distributorit te autorizuar. Ne kete procedure prokurimi te dy kompanite kane ofertuar si tregëtues, me produkte te te njejtit prodhues, per te cilat jane pasjiur me autorizime nga e njejta kompani e konkretisht ANHEL SHPK; ne cilësine e nje kompanie e cila eshte distributore e autorizuar e nje kompanie turke. Ne keto rrethana kemi te drejte te besojme se, ofertuesit Malvina Visoka PF dhe AN&RA SHPK edhe pse kane firmosur shtojcën 8 (FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT), pra edhe deklaraten per dorezimin e Ofertave te pavarura, piken 6/a) te saj ku deklarohet se, Ofertuesi ka pergatitur ofertën e tij ne menyre te pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bere marreveshje apo pa rene dakord me asje konkurrent jeter, si dhe deklarimet sipas pikave 7, 8 dhe 9 te këtij formulari, ofertimi me te njejtin produkt dhe te autorizuar nga e njejta kompani, sjell nje ofertim i cili nuk ishte i pavarur, pasi shoqerite minimalisht jane marre vesh per cmimet me te cilat kane ofertuar. Diferenca e vogël ne cmim e provon këte fakt. Duke shpresuar ne nje vleresim te drejte objektiv, profesional nga ana juaj dhe ne perputhje me qellimet dhe parimet e ligjit te prokurimit publik, kerkojme pranimin e plote te ankeses tone. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses pasi mori ne shqyrtim pretendimin e Operatorit Ekonomik ankues Euro Mega 2010 per skualifikimin e tij pasi edhe ky i fundit e pranon qe gjate ankesës në këtë procedure eshte paraqitur me dy oferta te ndryshme Sipas Ligjit te Prokurimit Neni 91 Ndalimi i modifikimit te ofertave 1. Pas afatit perfundimtar per hapjen e ofertes nuk duhet te kryhet asnje bisedim ndermjet autoritetit ose entit kontraktor dhe ofertuesit per vlerën e ofertes, ne perputhje me parashikimet e këtij ligji. 2. Nje ofertuesi, si kusht per shpalljen fitues, nuk duhet t'i kerkohet qe te ndermarre pergjegjësi të papercaktuara ne dokumentet e tenderit, te ndryshoje vlerën e ofertes se tij ose te modifikoje ne çfaredolloj menyre oferten. 3. Dispozitat e ketij neni nuk cenojne zbatimin e neneve 44, 45, 46 dhe 47 te këtij ligji. Ndersa ne VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik ne nenin Neni 79 Dorezimi i ofertave 1. Ofertat duhet te dorezohen ne adresën e percaktuar ne dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, te percaktuar ne këto dokumente si afati i fundit per dorezimin e tyre. 4.Operatorët ekonomike duhet te paraqesin vetem ne oferte, me perjashtim te rasteve kur kerkohen oferta alternative. Nga verifikimi ne sistem Operatori Ankimues Euro Mega 2010 Shpk ka hedhur dy oferta me cmim te ndryshem dhe me objekt te njejte. Persa me lart ligji e*

*ndalon modifikimin ose hedhjen e me shume se nje oferte ne nje procedure prokurimi. Ne vazhdim ankoheni per vazhdimin e procedures si edhe per operatorët e tjere konkurues persa te cilën nuk keni vendosur asnje dokument ne dispozicion dhe keni te gjitha aludime. Per sa me siper Operatori Ankimues Euro Mega 2010 shpk qendron i skualifikuar dhe nuk legjitimohet per vazhdimin e ankesës ndaj operatoreve te tjere. Bazuar sa me siper, KSHA gykon se per te mbeshtetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej te kishte Shoqeruar ankesen e tij me prova, indice dhe argumenta ose dokumentacionin perkates, ne baze te të cilave do te shqyrtohej kjo ankesë ndersa sic verehet ne ankese nuk ka asnje dokumentacion provues po vetem indicie. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin qe ta beje te identifikueshem pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra te evidentoje qarte dhe sakte se ku e bazon pretendimin e tij per mospermbushjen e kriterit/kritereve Theksojme se mospermbushja e specifikimeve teknike apo kushteve te vendosura nga autoriteti kontraktor mund te vije per shkaqe te ndryshme, siç jane mosparaqitja e nje dokumenti të kerkuar, ose problematika qe mund të prekin dokumentin etj. Eshte barre e operatorit ekonomik ankues qe të percaktoje se ne cilin fakt apo rrethanë e mbeshtet pretendimin e tij per spermbushje kriteri/kriteresh.*

*Per sa me siper, pretendimet e ankimuesit "Euro Mega 2010" SHPK nuk qëndron.*

*Per sa me siper, në mbeshtetje te neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 te ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave,*

*Vendosi*

*1. Refuzimin e ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SH.P.K per Vleresimin e procedures se prokurimit: "Procedure e hapur", "Blerje Detergjent per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve" me fond limit 39.951.333 leke pa TVSH", me nr, REF-96420- 02-26-2024 me date te publikimit te njoftimit te anullimit ne SPE, date 15.04.2024.*

*2. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, dhe operatoret ekonomik te interesuar brenda dites se neserme te punës nga marrja e ketij vendimi. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se nesërme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.*

*Duke ju falënderuar per mirekuptimin*

II.11. Me shkresën nr. 971/6 prot, datë 09.05.2024, pranë Komisionit të Prolurimit Publik, është protokolluar shkresa "*Shpjegime shtesë referuar vendimit të KSHA-së nr. 69/1 prot, datë 30.05.2024"* e operatorit ekonomik ankimues.

II.12. Me shkresën nr. 971/7 prot., datë 10.05.2024, me objekt "*Njoftim përseancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues, duke i informuar si më poshtë vijon:

*Komisioni i Prokurimit Publik është duke shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur", me Nr. REF-96420-02-26-2024, me objekt "Blerje detergjent, për Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve", me fond limit 39,951,333 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 20.03.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.*

*Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK.*

*Nisur dhe nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK e cila është:*

1. *Operatori Ekonomik nuk plotëson kërkesën në DST për numrin e ofertave të lejuara në procën e prokruimit nga një ofertues pasi rezulton se ky ofertues paraqiti dy oferta ekonomike. Konkretisht EURO MEGA 2010, ka ngarkuar në SPE dy oferta ekonomike në vlerat: Oferta 1: 33,650,000 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë) Oferta 2.: 27,320,000 (njzetë e shtatë milion milion e treqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë). Referuar DST Seksioni i Përgjithshem në këtë procedutrë nuk lejohet më shumë se 1 ofertë ose ofertë alternative. Në zbatim të nenit pikës 4 të nenit 79 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative dhe për këtë arsye subjekti EUROMEGA 2010 s'kualifikohet nga renditja në këtë procedurë dhe ofertat refuzohen.*

*Komisioni Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" si nenit 23 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të operatorit ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor konkretisht Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, të cilët të disponojnë të dhënat për tu futur në llogaritë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektonik.*

*Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e hënë, datë 13.05.2024, ora 12:30.*

*Për sa më sipër, ju kërkojmë të gjithë palëve të siguroni pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë dëgjimore sipas njoftimit të mësipërm.*

II.13. Në datën 13.05.2024, ora 12:30, në prani të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor z. I. N dhe E. M, përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues "*Euro Mega 2010"* SHPK, dhe në prani të Komisionit të Prokurimit Publik, në ambientet e KPP-së u mbajt seancë dëgjimore me regjistrim audio të seancës. Në këtë seancë përfaqësuesit e autoritetit kontraktor dhe operatorit

ekonomik ankimues, dhanë argumentet e tyre lidhur me pretendimet e ngritura nga ankimuesi në ankesë. Në seancë nga ana e Komisionit, u pyeten palët nëse kanë kërkesa paraprake. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues u konfirmua se nuk ka kërkesa paraprake, ndërsa përfaqësuesit e autoritetit kontraktor paraqitën në seancë parashtrimet e tyre me shkrim të cilat u administruan në dosjen objekt shqyrtimi me nr. 971/8 prot, datë 13.05.2024. Ne vijim të seancës dëgjimore Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua operatorit ekonomik ankimues, duke i kërkuar që të logohet në llogarinë e tij në sistemin e prokurimit elektronik, në seksionin operatori ekonomik, për të verifikuar ofertën e dorëzuar prej tij në këtë procedurë prokurimi nëse janë 1 (një) apo 2 (dy) oferta të ngarkuara. Pasi përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues "Euro Mega" SHPK u logua në sistemin e prokurimit publik në llogarinë e tij si operator ekonomik, u shfaq imazhi i dokumenteve të ngarkuara në SPE në seksionin oferta të dorëzuar nga ky operator ekonomik, ku evidentohet edhe dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën "oferta burgjeve FINALE10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf (303,9 kB)", si më poshtë vijon:




AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK Prokurimi elektronik - Seksioni i operatorit ekonomik
Formulari
Profili/Periudha
Bashkimi i operatoreve ekonomike
Dokumente Teknike
Skedar i Bashkëngjitur
Krijuar
furnizime te ngjashme 2.pdf (2,98 MB) 11.03.2024 12:52
DOKUMENTACION TEKNIK PRODUKTET.pdf (11,84 MB) 11.03.2024 14:10
DEKLARATA_PER_MJETIN.pdf (331 kB) 19.03.2024 14:01
BILANCI_2020.pdf (2,9 MB) 11.03.2024 12:34
PATENTA MUHAMET MINJA.pdf (86,2 kB) 11.03.2024 16:55
Bilanci_2022_Euro_Mega_2010.pdf (7,23 MB) 11.03.2024 12:35
SKEDA TEKNIKE ROSE SOAP.pdf (5,68 MB) 18.03.2024 15:51
DOKUMENTACION I PLOTE AA982LN.pdf (5,83 MB) 11.03.2024 12:26
ANALIZAT E PRODUKTEVE.pdf (9,75 MB) 11.03.2024 14:12
Furnizimet e ngjashme 1.pdf (11,03 MB) 11.03.2024 12:54
DEKLARATA_MBI_TRANSPORTIN_E_MALLRAVE.pdf (314,2 kB) 11.03.2024 13:04
VERTETIM XHIRO 19 03 2024.pdf (241,6 kB) 19.03.2024 14:03
DOKUMENTACION PER PUNONJESIT.pdf (4,2 MB) 11.03.2024 16:54
BILANCI_2021.pdf (3,47 MB) 11.03.2024 12:34
Hapi i Mëparshëm
Hapi Tjetër
Mbyll
Vendi i punes
Ndihma Profili im
Operatori Ekonomik
Procedurat e Publikuara
Marrëveshja Kuader
Tenderat që u ka kaluar
Procedura të Mbyllura
Kërkesat
Kërkesat e mia
Kerkesa nga AK
Kerkesa te tjera
Tenderat e Mi
Oferta te paperfundu
Oferta te dorezuara
Mesazhe (393)
Vazhdo
Refuzo
E përfundu
© APP. Të gjithë të drejtat e rezervuara. v.4.5.7.28
Perdoruesi: EURO MEGA 2010
Roli: Economic Operat


AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK Prokurimi elektronik - Seksioni i operatorit ekonomik
Formulari
Profili/Periudha
Bashkimi i operatoreve ekonomike
PATENTA MUHAMET MINJA.pdf (86,2 kB) 11.03.2024 16:55
Bilanci_2022_Euro_Mega_2010.pdf (7,23 MB) 11.03.2024 12:35
SKEDA TEKNIKE ROSE SOAP.pdf (5,68 MB) 18.03.2024 15:51
DOKUMENTACION I PLOTE AA982LN.pdf (5,83 MB) 11.03.2024 12:26
ANALIZAT E PRODUKTEVE.pdf (9,75 MB) 11.03.2024 14:12
Furnizimet e ngjashme 1.pdf (11,03 MB) 11.03.2024 12:54
DEKLARATA_MBI_TRANSPORTIN_E_MALLRAVE.pdf (314,2 kB) 11.03.2024 13:04
VERTETIM XHIRO 19 03 2024.pdf (241,6 kB) 19.03.2024 14:03
DOKUMENTACION PER PUNONJESIT.pdf (4,2 MB) 11.03.2024 16:54
BILANCI_2021.pdf (3,47 MB) 11.03.2024 12:34
DEKLARATA_PER_STAFIN.pdf (315,2 kB) 19.03.2024 14:06
Hapi i Mëparshëm
Hapi Tjetër
Mbyll
Vendi i punes
Ndihma Profili im
Operatori Ekonomik
Procedurat e Publikuara
Marrëveshja Kuader
Tenderat që u ka kaluar
Procedura të Mbyllura
Kërkesat
Kërkesat e mia
Kerkesa nga AK
Kerkesa te tjera
Tenderat e Mi
Oferta te paperfundu
Oferta te dorezuara
Mesazhe (393)
Vazhdo
Refuzo
E përfunduar
© APP. Të gjithë të drejtat e rezervuara. v.4.5.7.28
Perdoruesi: EURO MEGA 2010
Roli: Economic Operator


AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
Prokurimi elektronik - Seksioni i operatorit ekonomik
Mesazh
Informacion
Procedurë për Tendera
Blerje Detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
Numri i References
REF-96420-02-26-2024
Autoriteti Kontraktues
Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Subjekti
Disa dokumenta jane fshire nga oferta: OFFER-8040/11032024
Pershendetje Operator Ekonomik, disa dokumenta jane fshire nga oferta juaj: OFFER-8040/11032024 per proceduren REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve).
Dokumenta te fshire nga oferta jane:
Oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf
Tjetër
Mbyll
Perdoruesi: EURO MEGA 2010
Roli: Economic Operator


AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
Prokurimi elektronik - Seksioni i operatorit ekonomik
Mesazh
Informacion
Procedurë për Tendera
Blerje Detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
Numri i References
REF-96420-02-26-2024
Autoriteti Kontraktues
Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Subjekti
Oferta juaj OFFER-8040/11032024 eshte e paperfunduar
Pershendetje Operator Ekonomik, oferta juaj OFFER-8040/11032024 per tenderin REF-96420-02-26-2024 (Blerje Detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve) eshte e paperfunduar.
Tjetër
Mbyll
Perdoruesi: EURO MEGA 2010
Roli: Economic Operator







Komisioni i Prokurimit Publik pasi kreu verifikimet, beri pjesë të fashikullit administrativ printscreen e imazheve të llogarisë së operatorit ekonomik ankimues "Euro Mega" SHPK, i komunikoi këtij të fundit që të dalë nga llogaria e tij në sistemin e prokurimit elektrionik.

Pas këtij veprimi procedural, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, që të logohen në sistemin e prokurimit elektronik, në seksionin e autoritetit kontraktues, për të verifikuar dokumentacionin e dorëzuar në skedarin e ofertave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues “Euro Mega 2010” SHPK, pra për të verifikuar ofertën e dorëzuar prej këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi, nëse operatori ekonomik ka dorëzuar 1 (një) apo 2 (dy) oferta në SPE.Pasi përfaqësuesi i autoritetit kontraktor u logua në sistemin e prokurimit publik, në llogarinë e tij si autoritet kontraktor, u shfaq imazhi i dokumenteve të ngarkuara në SPE në seksionin oferta, të dorëzuar nga operatori ekonomik “Euro Mega” SHPK, ku evidentohen dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën “oferta e burgjeve FINALE.pdf (311165), krijuar më datë 20.03.2024, ora 10:56”, dhe dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën “oferta ekonomike.pdf (312661) krijuar më datë 19.03.2024, ora 13:55”, si më poshtë vijon.






II.14. Me shkresën nr. 971/8 prot., datë 13.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar dokumenti me emërtesën "*Parashtresë mbi Rrethanat e skualifikimit të operatorit ekonomik Euro Mega 2010 SHPK*" nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

*Ne lidhje me proceduren admistrative inicuar nga ana juaj sipas shkresës Nr.971/7 dt.10.05.2024, dhe në zbatim te autorizimit te Titullarit te OBP per te marre pjese ne senacen degjimore te thirrur nga KPP mbi shqyrtimin e ankeses të subjektit EURO MEGA 2010 sh.p.k, ne proceduren e prokurimit ne forme elektronike: Tender i Hapur me objekt: "Blerje Detergjent per Drejtorine e Përgjithshme të Burgjeve", me fond te pergjithshem: 39,951,333, REF-96420-02-26-2024, KVO e ngarkuar për këtë procedure paraqet me shkrim nje parashtrese mbi procedurat e ndjekura nga ana jone ne vleresimin e ofertes se subjekti i cili rezultoi me dy oferta ekonomike ne SPE. Afati i Hapjes se ofertave: date 20.03.2024 ora 11:00.*

*Ne lidhje me këte procedure sqarojme dhe argumentojme si me poshte vijon:*

*Ofertat janë hapur ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) në datën 20.03.2024, në orarin e percaktuar (ora 11:00). Komisioni i Vleresimit te Ofertave pasi verifikoi ne SPE ofertat e operatoreve ekonomike pjesmarres, konstatoi se ne llogarine e Operatorit Ekonomik, "Skedari me titull "Formulari i ofertes" subjekti EURO MEGA 2010 sh.p.k kishte ngarkuar 2 oferta ekonomike perkatesisht:*

*• Dokument elektronik me titull "Oferta Finale" pdf, i cili permbante:*

*- Formulari i Ofertës Shtoja 1: me vlere 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqind e njezete mijë) lekë pa TVSH (gjithsej dy fletë) nënshkruar dhe vulosur nga Administratori i subjektit EURO MEGA 2010.*
*- Lista e Cmimeve dhe Artikujve Shtojca 2: me vlere me vlere 27,320,000 (njezete e shtate milion e treqind e njezete mije) lekë pa TVSH (me numra dhe fjalë).*
*Data dhe Ora e ngarkimit te ofertes: Date 20.03.2024 Ora 10:46*

• *Dokument elektronik me titull "Oferta Ekonomike" pdf, i cili permbante:*
*-Formulari i Ofertës Shtojca 1: me vlere 33,655,000 (tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) leke pa TVSH (gjithsej dy flete) nënshkruar dhe vulosur nga Administratori i subjektit EURO MEGA 2010.*
*-Lista e Cmimeve dhe Artikujve Shtojca 2: me vlere 33,655,000 tridhjete e tre milion e gjashteqinde pesedhjete e pese mije) leke pa TVSH (gjithsej dy flete) nënshkruar dhe vulosur nga Administratori i subjektit EURO MEGA 2010.*
*Data dhe Ora e ngarkimit te ofertes: Date 19.03.2024 Ora 13:55*

*KVO kontrolloi me kujdes te dhenat e formularit te cmimit shtojca 1 dhe shtojca 2, dhe pasi konstatoi se formularit e ofertave kane te njejtin objekt dhe numër reference me proceduren e shpallur, arriti ne konkluzion shterues se në SPE figurojne dy oferta ekonomike dhe e pasqyroi kete fakt ne procesverbalet e procedures. Ne date 04.04.2024 KVO ka marre vendimin perfundimtar per vleresimin e procedures dhe ka s'kualifikuar operatorin ekonomik EURO MEGA 2010 sh.p.k mbeshtetur ne Legjislacionin ne fuqi dhe rregullat e prokurimit dhe DST ku citojme:*

*Referuar DST Seksioni i Pergjithshem ne kete procedure nuk lejohet me shume se 1 oferte ose oferte alternative, dhe ne zbatim te nenit pikes 4 të nenit 79 të VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 "Per miratimin e regullave te prokurimit publik" ku percaktohet se: "Operatorët ekonomike duhet te paraqesin vetem nje oferte, me perjashtim te rasteve kur kerkohen oferta alternative" dhe per kete arsye subjekti EURO MEGA 2010 s'kualifikohet nga renditja ne kite procedure dhe ofertat refuzohen.*

*Arsyetimi Komisionit te Vleresimit të Ofertave mbi arsyet perse nuk mund te veprohet ndryshe pervese me s'kualfikim te operatorit ekonomik qe rezultoi me dy oferta ekonomike në SPE.*

*Se pari, ne lidhje me vendimin per s'kualfikimin e operatorit EURO MEGA 2010 sh.p.k, KVO eshte mbeshtetur ne parashikimet ligjore dhe nenligjore, percaktimet ne vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 245 dt. 19.05.202, në Dokumentet Standarte të Tenderit, Manualin Teknik te APP Nr. 1 dt. 24.12.2021, si dhe ne kushtet kur nuk ka patur asnje njoftim nga Agencia e Prokurimit Publik apo operatorët ekonomike pjesëmarres per defekte apo keqkunksionim te SPE (duke filluar nga dita e hapjes se ofertave dhe deri ne ditën e vleresimit te ofertave). KVO konstatoi se te gjithë operatorët kanë ngarkuar rregullisht ofertat, dhe nuk ka patur asnje arsye ligjore dhe procedurale te dyshonte per rezultatet e Sistemit të Prokurimit.*

*Se dyti, veprimet e kryera ne llogarine personale dhe konfidenciale te ofertuesit jane pergjegjesi ligjore e vete operatorit ekonomik EURO MEGA 2010 sh.p.k dhe ne rastin e ofertes te dorezuar nga subjekti ne Sistemi i Prokurimit Elektronik "Skedari i Operatorit Ekonomik" qartesisht evidentone dy oferta ekonomike me te njejtin objekt dhe me te njejtin numer reference me procedurën e shpallur, te ngarkuara ne orare të ndryshme.. Këto dokumente janë nenshkuar dhe vulosur nga operatori ekonomik ne*
*perputhje me Shtojcën 1 te DST "Formulari i Ofertes Ekonomike" dhe dhe Shtojce 2 të DST "Lista e Cmimeve dhe Artikujve".*

*Ne rrethanat e paraqitura KVO eshte perballur me dy dokumente te ndryshëm elektronike me titull "Oferta finale" dhe "Oferta ekonomike" te cilët nga pikpamja formale jane ne perputhje me percaktimet ne Manualin Teknik te APP Nr. 1 dt. 24.12.2021 e APP "Per regjistrimin e operatoreve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne SPE" ku citojme manualin: Kujdes: Emërtimi i dokumentit te "Ofertes Ekonomike" që ngarkohet ne këtë seksion duhet te jete pa simbole te veçanta si dhe pa numra p.sh. Formular Oferte, Oferta Ekonomike, Oferte... etj. Ne keto kushte KVO nuk ka patur anje mundesi procedurale tjeter pervec se te hapte dokumentet elektronike dhe te rregjistronte permbajtjen e tyre, ku qartesisht rezultoi se nga operatori ekonomik jane hartuar vulosur dhe nenshkuar dy oferta ekonomike me vlera te ndryshme qe kanë si pasoje juridike s'kualifikimin e operatorit ekonomik. Ne lidhje me pretendimet e OE EURO MEGA 2010 shpk, i cili pretendon "per probleme në SPE" theksojme se "veprimet dhe mosveprimet e operatorit apo gabimet e tij apo punonjesve te tij ne procesin e hedhjes, ngarkimit te ofertes ne kohen dhe vendin e duhur, jane pergjegjesi e operatorit ekonomik, dhe qartesisht operatori ka pergjegjesi që nuk arriti te hiqte ne kohe oferten e pare dhe te ngarkonte një oferte tjeter, në kushtet kur te gjithe operatorët e tjere pjesemarres e kanë kryer ne rregull procesin e paraqitjes se ofertes ne forme elektronike" Subjekti EURO MEGA 2010 sh.p.k pretendon se ka tentuar te ndryshoje oferten ekonomike veprim ky i ligjshem, por sjellim ne vemendjen tuaj, se ky veprim eshtë kryer vetem 4 min para skadimit te afatit te ofertave fakt i cili ngarkon me pergjegjesi direkte per cdo gabim te mundshem apo keqfunksionim te infrastruktures vete subjektin i cili tenton te fshije ofertën ne momentin e fundit. Kjo pergjegjesi percaktohet qarte ne faqen 26 të Manualit te APP "Per registrimin e operatorëve ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne SPE" ku citojme manualin: Kujdes: Operatori Ekonomik duhet te ofertoje ne kohë dhe te bej dorezimin e ofertes në kohë duke bere ne këte menyre shmangien e problematikave te mundshme qe mund të vijne nga ana e infrastruktures dhe veprimeve te operatoreve ekonomike. Ne këtë menyre operatori ekonomik duhet te kontaktojë ne kohe me suportin e SPE dhe duke i dhëne kohën e domosdoshme per identifikim dhe suport stafit te suportit me qellim ofertimin ne kohë. Ne rast se ofertimi lihet ne momentin e fundit problemi ne infrastrukture dhe veprimet e operatorit ekonomik merren persiper nga ky i fundit.*

*Se treti, ne kushtet kur nga SPE u admistruan dy oferta KVO nuk mund të verifikonte dhe ti kerkonte sqarim operatorit eknonomik se perse ka hedhur dy oferta sepse nuk mund te verifikohet nje fakt juridik i provuar me dokumente ne kete rast hedhja e dy ofertave. Shprehim bindjen se ne rethanat e paraqitura nuk ka asnje dispozitë ligjore apo neligjore ku KVO mund t'i referohej si baze ligjore per te ndryshuar vendimarrjen ne këte rast. Gjithashtu nga praktika*

*e gjere ne vite e autoritetve kontraktore, praktika e Agencise Sheterore e Prokurimeve te Perqëndrura, nuk ka asnje precedent që ne rastin paraqitjes se dy ofertave ne SPE (dhe ne kushte kur nuk ka asnje njoftim nga APP per keqfunksionim te SPE), te jete perzgjedhur oferta me e ulët ne klasifikim. Pra shprehim bindjen se KVO ka vepruar ne perputhje me rregulllat e prokurimit publik dhe se cdo veprim per pranimin e ofertes me vlere te ulet nga dy ofertat e regjistruara ne SPE do te perbente nje shkelje te dispozitave dhe parimeve thelbesore te prokrurimit publik.*

II.15. Me shkresën nr. 971/9 prot., datë 15.05.2024, me objekt "*Kërkesë për Informacion*", Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Agjencisë së Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

*[.....]*

*Sa më sipër, me qëllim shqyrtimin e ankesës, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", duke marrë shkak nga informacioni i sipërcituar si dhe në zbatim të nenit 23 gërma (b), (ç), (f) dhe (l) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm të kërkojë nga ana juaj një sqarim dhe informacion se cila është arsyeja e shfaqjes së 2 (dy) ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike autoritetit kontraktor, ndërkohë që nga veprimet e sipërcituara në llogarinë e operatorit ekonomik ankimues "Euro Mega" SHPK rezulton e ngarkuar në SPE vetëm 1 (një) ofertë aktive për këtë procedurë. Pas verifikimeve nga ana juaj kërkojmë gjithashtu të na sqaroni nëse ndodhemi në shkelje të nenit 79 pika 4 e VKM 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nga ana e operatorit ekonomik ankimues. [....]*

II.16. Me shkresën nr. 3676/1 prot., datë 28.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 971/10 prot, datë 29.05.2024, pranë Komisionit Prokurimit Publik është dërguar informacion me objekt "*Kthim - përgjigje*" nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik, me përmbajtje si më poshtë vijon:

*Agjencia e Prokurimit Publik (ne vijim "APP") mori ne shqyrtim shkresën e Komisionit të Prokurimit Publik (ne vijim "KPP") me Nr. 971/9 Prot., date 15.05.2024, te protokolluar ne institucion me Nr. 3676 Prot., date 17.05.2024, me objekt "Kerkese per informacion".*

*Nga shyrtimi i shkreses se derguar konstatojme se, ne cilesinë e organit me të larte te shaqrtimit te ankesave jeni ne proces te shyrtimit te ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" sh.p.k per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Detergjentë per Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve" nr. REF-96420-02-26-2024 te zhvilluar nga Agjencia Shteterore e Prokurimeve te Perqendruara (ne vijim "ASHPP").*

*Ne vijim te shqyrtimit te ksaj ankese, nga ana juaj kerkohet sqarim dhe informacion se, cila eshte arsyeja e shfaqjes se dy ofertave ne sistemin e prokurimeve elektronike, autoritetit*

*kontraktor, nderkohe qe nga veprimet e kryera ne llogarine e operatorit ekonomik ankues rezulton e ngarkuar vetem nje oferte aktive. Gjithashtu, kerkoni sqarim nese ndodhemi ne kushtet e nenit 79/4 të VKM 285/2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar (ne vijim "VKM").*

*Lidhur me sa kerkoni ne shkresën tuaj, sqarojme se, APP i ushtron kompetencat e saj ne baze dhe zbatim te nenit 23 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", te ndryshuar (në vijim "LPP"), si dhe akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij. Lidhur me rastin ne fjale, sqarojme se, operatori ekonomik "EURO MEGA 2010" sh.p.k ne shkresën me Nr. 2995 Prot., date 15.04.2024 te dërguar ne APP, ka parashtruar se, ka ngarkuar nje formular te ofertes ekonomike ne seksionin "Oferta Ekonomike" ne proceduren e mësiperme te prokurimit, nderkohe autoriteti kontraktor pretendonte se i jane shfaqur dy te tille dhe per kete arsye ka e skualifikuar oferten e tij.*

*Në lidhje me situaten e parashtruar nga operatori ekonomik per proceduren ne fjale, sqarojme se, nga autoriteti kontraktor, ASHPP, i cili ka zhvilluar kete procedure prokurimi, nuk eshte iniciuar asnje kerkese per suport me qellim asistencen e ketij te fundit.*

*Nderkohë, menjehere me marrjen e shkresës se derguar nga operatori ekonomik, APP ka raportuar problematiken prane specialisteve te IT te Agjencia Kombëtare e Shoqerise se Informacioni (në vijim "AKSHI"), te atashuar prane APP si dhe kompanise se Mirembajtjes se Sistemit te Prokurimit Elektronik, e kontraktuar nga AKSHI, referuar kontrates Nr. 64, date 31.07.2023 me objekt: "Sherbimi i mirembajtjes se Sistemit te Prokurimit Elektronik".*

*Pas investigimeve te kryera nga kompania e mirembajtjes, APP i ka vendosur ne dispozicion operatorit ekonomik "EURO MEGA 2010" sh.p.k, pergjigjen e derguar nga kompania e mirembajtjes.*

*Gjithashtu, APP ka vene ne dijeni AKSHI-n ne lidhje me problematiken e sipercituar si institucioni i cili administron Sistemin e Prokurimit Elektronik referuar Ligjit Nr. 43/2023 "Per qeverisjen elektronike", ne shkresën me Nr. 3299 Prot., date 29.04.2024.*

*Bashkëlidhur, do te gjeni shkresën me Nr. 2995/1 Prot., date 08.05.2024 drejtuar operatorit ekonomik "EURO MEGA 2010" sh.p.k, si dhe shkresën me Nr. 3299 Prot., date 29.04.2024 drejtuar AKSHI-t.*

*Se fundmi, sa i takon sqarimit te kerkuar nise ndodheni ne kushtet e nenit 79/4 te VKM, sjellim ne vemendje se, ne nenin 24 te LPP, parashikohet se: "1. Komisioni i Prokurimit Publik eshte organi me i larte administrativ ne fushën e prokurimeve, ge shayrton ankesat per procedurat e prokurimit dhe kryen do detyre jeter ge i ngarkohet me kite ligi dhe akte te tjera ligjore brenda fushes se kompetencave të tij".*

*Ne këte kuptim, referuar parashikimeve ligjore ne fuqi, vendimmarrja per vleresimin e kesaj ankese pas vleresimit te gjithe pretendimeve dhe rrethanave te ceshtjes, i takon institucionit*

*tuaj, si institucioni me i larte qe shqyrton administrativisht ankesat per procedurat e prokurimit.*

*Agjencia e Prokurimit Publik (ne vijim "APP") mori ne shqyrtim shkresën tuaj te protokolluar ne institucion me Nr. 2995 Prot., date 15.04.2024 me objekt: "Kerkese per informacion në lidhje me ofertën e dorezuar per proceduren e prokurimit me objekt: "Blerje Detergjente per Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve", me REF-96420-02-26-2024".*

*Nga shqyrtimi i shkresës tuaj, konstatojme se operatori juaj ekonomik parashtron se ka ngarkuar nje formular te ofertes ekonomike ne seksionin "Oferta Ekonomike proceduren e prokurimit me objekt: "Blerje Detergjente per Drejtorine e Pergjthshime Burgjeve" dhe REF-96420-02-26-2024 e publikuar nga autoriteti kontraktor Agjencia Shteterore e Prokurimeve te Perqendruara (ne vijim "ASHPP"), por autoriteti kontraktor pretendon se i jane shfaqur dy formulare oferte ekonomike dhe per kete arsye ka skualifikuar ofertën tuaj.*

*Menjehere me ardhjen e shkresës prane APP, nga ana jone eshte raportuar problematika prane kompanise se Mirembajtjes se Sistemit te Prokurimit Elektronik, e kontraktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqerise se Informacioni (ne vijim "AKSHI" referuar kontrates Nr. 64, date 31.07.2023 me objekt: "Shërbimi i mirembajtjes se Sistemit te Prokurimit Elektronik"*

*Nga investigimi i kryer nga kompania e mirembajtjes, rezulton si me poshte:*

*Logjika aktuale e sistemit në rastet kur Operatori Ekonomik kryen veprime si fshirje te nje skedari ekeistues apo ngarkim te nje skedari te ri ofertimi, eshte qe dokumentet e ofertimit qe nuk jane ne ambientin E-Filling, por janë ne ambientin Core, të fshihen edhe nga ambienti Core, por vetem nese koha e lejuar per ofertim nuk ka perfunduar ende.*

*Ne rastin konkret, operatori ekonomik ka ngarkuar skedarin e pare te ofertimit, më pas në momentet e fundit të kohes aktive per ofertim kane fshirë skedarin ekzistues dhe kane ngarkuar nje te ri, skedarin e dyte. Duke qene se këto veprime janë kryer ne momentet e fundit të ofertimit, si pasoje janë reflektuar ne ambientin Core ne sinkronizimin e rradhes, ateherë kur koha aktive per ofertim ka perfunduar.*

*Ne kushtet aktuale sistemi nuk lejon fshirjen e dokumenteve në ambientin Core (edhe pse ato nuk ekzistojne me ne E-Filing) ne rast se koha aktive per ofertim ka perfunduar. Kjo eshte arsyeja pse Autoritetit Kontraktues i shfaqen në ambientin Core te dy skedarët e ofertimit per secilin OE, skedari i pare i cili eshte fshirë nga OE në ambientin E-Filing dhe skedari i dytë i ofertimit i ngarkuar nga ky i fundit ne momentet e fundit të kohës së lejuar per ofertim."*

*Gjithashtu, sjellim ne vemendjen tuaj se, referuar Manualit Nr. 1, date 24.12.2021 "Për registrimin e operatorive ekonomike dhe dorezimin e ofertave ne Sistemin e Prokurimit Elektronik" citohet:*

*"Kujdes: Operatori Ekonomik duhet te ofertojë në kohe dhe te bej dorezimin e ofertes në kohe duke bere ne kete menyre shmangien e problematikave te mundshme qe mund të vijne nga ana e infrastruktures dhe veprimeve te operatoreve ekonomike.*

*Ne kete menyre operatori ekonomik duhet te kontaktoje në kohë me suportin e SPE dhe duke i dhene kohen e domosdoshme per identifikim dhe suport stafit te suportit me qellim ofertimin ne kohe.*

*Ne rast se ofertimi lihet ne momentin e fundit problemi ne infrastrukture dhe veprimet e operatorit ekonomik merren persiper nga ky i fundit".*

*Gjithashtu, persa keni kerkuar ne lidhje me kopjen e dokumenteve tek skedari "Formulari i ofertes ekonomike, ju sqarojme se ne kete faze qe ndodhet procedura e prokurimit dokumentet aksesohen vetem nga autoriteti kontraktor.*

*Ne këto kushte, duhet t'i drejtoheni Operatorit te Blerjeve te Perqendruara (ish "ASHPP"), i cili ne cilesine e autoritetit kontraktor që ka zhvilluar proceduren e prokurimit ne fjale, administron te gjithe dokumentacionin e plote te saj.*

*Se fundmi, sjellim ne vemendje te operatorit tuaj ekonomik se legjslacioni i prokurimit publik parashikon mekanizmin e ankimit per cdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi, dhe kur eshte demtuar ose rrezikohet te demtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, per te cilat pretendon se, jane ne kundershtim me ligjin. Pra, shoqeria juaj ka te drejte te ankohet prane autoriteti kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik, sipas parashikimeve te nenit 110 te LPP.*
*Duke ju falënderuar per mirekuptimin,*

**III**
**Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

**Arsyeton**

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", në të cilin parashikohet se "*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*", referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik

gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK ka lidhje me veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, nga verifikimi në SPE në seksionin hetim rezulton, se për procedurën e prokurimit objekt - ankimi në llogarinë e operatorit ekonomik "*Euro Mega*" SHPK e hetuar si auditues, rezulton i ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik SPE, dokumentacioni si më poshtë:


Profili/Periudha | Bashkimi i operatoreve ekonomike

Informacion

Operatori Ekonomik: EURO MEGA 2010 — Procedurë për Tendera: Blerje Detergjentë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Dokumente Faktesh

| Skedar i Bashkëngjitur | Krijuar |
|---|---|
| Vertetim per pagim detyrimesh11_03_2024.pdf (236,8 kB) | 11.03.2024 12:23 |
| shtojca nr 8 FORMULARI I VETDEKLARIMIT .pdf (624,6 kB) | 11.03.2024 17:43 |
| CertificatePassivStatus.pdf (234,2 kB) | 19.03.2024 14:22 |
| Ekstrakt_QKB_20240319.pdf (175 kB) | 19.03.2024 14:22 |
| Vertetim kontributet 11_03_2024.pdf (244,5 kB) | 11.03.2024 12:23 |
| VERTETIM DEBIE EURO MEGA ME JANARIN .pdf (398,9 kB) | 19.03.2024 13:56 |
| Certifikatë_Gjendjes_Gjygësore_22-02-2024.pdf (162,8 kB) | 19.03.2024 14:22 |
| sigurimi i ofertes 2 SIGAL.pdf (533,9 kB) | 18.03.2024 15:40 |

Formulari i Ofertes

| Skedar i Bashkëngjitur | Krijuar |
|---|---|
| oferta burgjeve FINALE.pdf (311165) | 20.03.2024 10:56 |
| Oferta ekonomike.pdf (312661) | 19.03.2024 13:55 |

Dokumente Teknike

| Skedar i Bashkëngjitur | Krijuar |
|---|---|
| furnizime te ngjashme 2.pdf (2,98 MB) | 11.03.2024 12:52 |
| DOKUMENTACION TEKNIK PRODUKTET.pdf (11,84 MB) | 11.03.2024 14:10 |
| DEKLARATA_PER_MJETIN.pdf (331 kB) | 19.03.2024 14:01 |
| BILANCI_2020.pdf (2,9 MB) | 11.03.2024 12:34 |
| PATENTA MUHAMET MINJA.pdf (86,2 kB) | 11.03.2024 16:55 |
| Bilanci_2022_Euro_Mega_2010.pdf (7,23 MB) | 11.03.2024 12:35 |
| SKEDA TEKNIKE ROSE SOAP.pdf (5,68 MB) | 18.03.2024 15:51 |
| DOKUMENTACION I PLOTE AA982LN.pdf (5,83 MB) | 11.03.2024 12:26 |
| ANALIZAT E PRODUKTEVE.pdf (9,75 MB) | 11.03.2024 14:12 |

1- Oferta e burgjeve finale pdf (311165) krijuar më datë 20.03.2024, ora 10:56, me vlerë 27,320,000 lekë pa TVSH.
2- Oferta ekonomike pdf (312661) krijuar më datë 19.03.2024, ora 13:55, me vlerë 33,655,000 lekë pa TVSH.

III.1.2. Në Seksionin II lista e shtojcave të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar si më poshtë vijon:

***Shtojca 1.***

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

***FORMULARI I OFERTËS***

*Data:*

*Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:*

*Për:* ***[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]***

*Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [****Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]***

*Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

***a)*** *Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:****[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]****, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.*

***b)*** *Ne* ***[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti****), nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës* ***[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]****.*

***c)*** *Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor* ***[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]****, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për* ***[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]*** *në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.*

***d)*** *Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:*

1. *Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;*
2. *Njoftimin e Kontrates;*
3. *Kriteret e Përzgjedhjes;*
4. *Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;*
5. *Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
6. *Kushtet e Veçanta të Kontratës;*
7. *Listat e Çmimeve të Artikujve.*

***e)*** *Çmimi total i Ofertës sonë,* ***pa TVSH****, është: -------------* ***[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];***

***f)*** *Çmimi total i Ofertës sonë,* ***me TVSH****, është: -------------* ***[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];***

| | |
|---|---|
| ***Emri i përfaqësuesit të ofertuesit*** | |
| ***Nënshkrimi*** | |

| | |
|---|---|
| ***Vula*** | |
| ***Datë*** ________________ | |

III.1.3. Në Seksionin I "*Udhëzime për Operatorët Ekonomikë*", pika 11 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| ***Paraqitja e Ofertave*** | *11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.*<br><br>*11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. __.*<br><br>***"MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ------------- d/m/v, në orën------------".*** |
| ***Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave*** | *Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.*<br><br>*Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.*<br><br>*Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.* |
| ***Ofertat me vonesë*** | *Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.* |

III.1.4. Në nenin 15 "*Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit",* të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. *Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.*

2. *Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:*

- *njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit*
- *njoftimin e kontratës;*
- *ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);*
- *udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;*
- *kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;*
- *formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;*
- *deklaratën e konfliktit të interesit;*
- *deklaratën e informacionit konfidencial;*
- *formularin e ofertës ekonomike;*
- *sigurimin e ofertës;*
- *njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;*
- *njoftimin e fituesit;*
- *formularin e ankesës;*
- *modelin e marrëveshjes kuadër;*
- *njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;*
- *model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;*
- *sigurimin e kontratës;*
- *njoftimin e lidhjes së kontratës;*
- *njoftimin e anulimit të procedurës.*

III.1.5. Në nenin 79 "*Dorëzimi i ofertave",* të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre.*

*Në rastin e procedurave që zhvillohen në formë shkresore, çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit/entit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit.*

*Operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.*

2. *Në rastin procedurave të prokurimit me një fazë, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë dhe ofertën ekonomike, në të njëjtën kohë.*

*Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, me vulën e shoqërisë.*

3. *Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, në fazën e parë të kualifikimit, dokumentacioni duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në dokumentet e tenderit. Në fazën e dytë e në vijim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë ofertën teknike dhe ofertën ekonomike.*

*Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, në secilën fazë, dokumentet e kualifikimit, oferta teknike dhe ajo ekonomike duhet të paraqiten respektivisht në zarfe të mbyllura, me vulën e shoqërisë.*

*Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.*

4. ***Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.***

III.1.6. Në nenin 115 "*Udhëzime dhe manualet shpjeguese",* të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*APP-ja harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për t'u ardhur në ndihmë të gjitha palëve gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit.*

III.1.7. Në nenin 23 gërma "b" dhe "ç" "*Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik",* të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*b) nxjerr vendime, udhëzime dhe rekomandime për mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik;*
*ç) jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik;*

III.1.8. Në nenin 42 "*Procedurë e Hapur",* të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Procedura e hapur është procedurë me një fazë, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.*

*Në procedurën e hapur, autoriteti ose enti kontraktor shpall një njoftim, sipas përcaktimeve në nenin 56 të këtij ligji, i cili përmban një përshkrim të objektit që do të prokurohet, në përputhje me parashikimet në rregullat e prokurimit publik.*
*2. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 35 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës.*
*3. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, kur autoriteti ka shpallur një njoftim paraprak ose në rastin e kontratave sektoriale kur enti kontraktor ka shpallur një njoftim periodik të informacionit, që në vetvete nuk është përdorur si mjet për të bërë ftesën për konkurrim, afati kohor minimal për pranimin e ofertave, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet në 15 ditë nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:*
*a) njoftimi paraprak i informacionit ose periodik i informacionit përfshin të gjithë informacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në rast se ai informacion është i disponueshëm në momentin kur shpallet njoftimi paraprak;*
*b) njoftimi paraprak i informacionit ose periodik i informacionit shpallet nga 35 ditë deri në 12 muaj përpara datës së shpalljes së njoftimit të kontratës.*
*4. Afati për dorëzimin e ofertave, përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet me 5 ditë kur ofertat paraqiten me mjete elektronike.*
*Në rast se dokumentet e tenderit nuk janë të disponueshme nëpërmjet mjeteve elektronike sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, afati për dorëzimin e ofertave, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, zgjatet me 5 ditë.*
*5. Për procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, afati për pranimin e ofertave është jo më pak se 20 ditë nga shpallja e njoftimit të kontratës dhe, në rast se ofertat paraqiten me mjete elektronike, ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë.*
*6. Përjashtimisht, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor argumenton se për shkak të një gjendje urgjence e ka të pamundur respektimin e afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, afati i pranimit të ofertave mund të shkurtohet deri në 15 ditë nga data në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës. Në çdo rast, argumentimi mbi arsyet e shkurtimit të këtij afati do të jepet nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e kontratës.*

III.1.9. Në nenin 89 "*Paraqitja dhe pranimi i ofertave",* të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton vendin, datën dhe orën e paraqitjes së ofertave.*
*2. Paraqitja e ofertave bëhet në një nga mënyrat e mëposhtme:*
*a) ofertat dorëzohen në rrugë elektronike, sipas përcaktimit në aktet nënligjore; ose*
*b) ofertat dorëzohen me shkrim, nëse një gjë e tillë është parashikuar në aktet nënligjore, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf.*
*3. Në rastet kur shtyhet afati përfundimtar i pranimit të ofertave në përputhje me parashikimet e këtij ligji, njoftimi për shtyrje të këtij afati publikohet në të njëjtën mënyrë siç është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.*

III.1.10. Me Vendimin Nr. 13, datë 28.12.2021, Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar Manualin Nr. 1, datë 24.12.2021 "*Për Regjistrimin e Operatorëve Ekonomikë dhe Dorëzimin e Ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik*", ku parashikohet shprehimisht se:

*Në dritaren e katërt seksioni "Oferta Ekonomike", operatori ekonomik duhet të ngarkojë vetëm ofertën ekonomike, e cila enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit.*







*Kujdes: Emërtimi i dokumentit të "Ofertës Ekonomike" që ngarkohet në këtë seksion duhet të jetë pa simbole të veçanta si dhe pa numra p.sh. Formular Oferte, Oferta Ekonomike, Ofertë… etj. Ky dokument, pasi ngarkohet në sistem enkriptohet për efekt sigurie dhe ruajtjes së informacionit por në datën e hapjes së procedurës nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave do bëhet e lexueshme.*




*Kujdes: Nëse tentoni të shtoni një dokument tjetër në këtë seksion, sistemi nuk do ju lejojë.*




*Në këtë rast, ju duhet të bëni në fillim fshirjen e dokumentit të ofertës së parë të bashkangjitur në sistem me anë të butonit "Fshi dokument" dhe pasi të keni ruajtur veprimet tuaja, mund të bashkangjitni një dokument tjetër në këtë seksion me anë të butonit "Shto dokument". Pasi të keni përfunduar me bashkëlidhjen e të gjithë dokumenteve, pjesë e ofertës tuaj për këtë procedurë prokurimi, klikoni butoni "Hapi tjetër" dhe zgjidhni opsionin e përfunduar "Po" për të dorëzuar ofertën tuaj pranë autoritetit kontraktor dhe më pas klikoni butonin "Hapi tjetër". Në këtë moment, oferta juaj do të kalojë te skedari "Tenderat e mi" – "Oferta të dorëzuara".*

*Kujdes: Të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në Sistemin e Prokurimit Elektronik, kanë të drejtë të heqin, të bashkëlidhin dokumente të reja në procedurat e prokurimit apo të tërheqin të gjithë ofertën, deri në datën dhe orën e përcaktuar në sistem si "Afati i fundit për pranimin e ofertave" nga autoritetet kontraktore.*

*Pasi kalon data dhe ora e përcaktuar në sistem si "Afati i fundit për pranimin e ofertave", nuk mund të bëhet asnjë ndryshim i dokumenteve të bashkëlidhura apo dorëzim i ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë, duke përfshirë këtu edhe aplikimet të cilat kanë ngarkuar dokumentacion apo janë lënë përgjysëm dhe rezultojnë me statusin të pa dorëzuar në sistem. Në rast se, në një ofertë të dorëzuar më parë nga ana juaj, fshini dokumentin e ofertës ekonomike të bashkangjitur tek seksioni "Oferta Ekonomike" automatikisht oferta juaj merr*

*statusin e pa përfunduar dhe do kalojë nga skedari "Tenderat e Mi" – "Oferta te përfunduara" në "Tenderat e Mi" – "Oferta te papërfunduara".*

*Kujdes: Operatori Ekonomik duhet të ofertojë në kohë dhe të bëj dorëzimin e ofertës në kohë duke bërë në këtë mënyrë shmangien e problematikave të mundshme që mund të vijnë nga ana e infrastrukturës dhe veprimeve të operatorëve ekonomikë.*

*Në këtë mënyrë operatori ekonomik duhet të kontaktojë në kohë me suportin e SPE dhe duke i dhënë kohën e domosdoshme për identifikim dhe suport stafit të suportit me qëllim ofertimin në kohë.*

*Në rast se ofertimi lihet në momentin e fundit problemi në infrastrukturë dhe veprimet e operatorit ekonomik merren përsipër nga ky i fundit.*

III.1.11. Në nenin 2 "*Qëllimi i ligjit*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.12. Në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.13. Në nenin 77, pika 5 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
***5.** Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*

III.1.14. Ndërsa në nenin 38 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të autorizojë ose t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin alternativa. Ata e përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose kur si mjet për të ftuar në konkurrim përdoret një njoftim paraprak ose periodik informacioni, në ftesën për shprehje interesi, nëse autorizojnë ose kërkojnë alternativa, në të kundërt alternativat nuk do të lejohen. Në çdo rast, alternativat lidhen me objektin e kontratës.*
*2. Autoriteti ose enti kontraktor që autorizon ose kërkon alternativa deklaron në dokumentet e tenderit kërkesat minimale që duhet të plotësojnë alternativat dhe çdo kërkesë specifike për paraqitjen e tyre, në veçanti nëse alternativat mund të dorëzohen vetëm pasi të jetë dorëzuar oferta, e cila nuk është një alternativë. Ata, gjithashtu, garantojnë që kriteret e përzgjedhura për shpalljen e kontratës fituese, të mund të zbatohen për alternativat që përmbushin këto kërkesa minimale, si edhe për ofertat e pajtueshme që nuk janë alternativa.*
*3. Në çdo rast, merren parasysh vetëm ato alternativa që plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*
*Në procedurat e prokurimit të kontratave publike për furnizime ose për shërbime, autoriteti ose enti kontraktor, që ka autorizuar ose kërkuar alternativat, nuk mund ta refuzojë një alternativë me arsyen e vetme që, nëse është i suksesshëm, do të çojë në një kontratë për shërbime në vend të një kontrate publike për furnizime ose në një kontratë për furnizime në vend të një kontrate publike për shërbime.*

III.1.15. Ndërsa në nenin 80 të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Kontratat jepen mbi bazën e kritereve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:*
*a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;*
*b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.*
*2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.*
*3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi*
*4. Në çdo rast, nëse autoriteti ose enti kontraktor vihet në dijeni të një fakti që është kusht për skualifikimin e operatorit ekonomik të shpallur fitues, deri në momentin e lidhjes së kontratës merr vendim për skualifikimin e tij sipas parashikimeve në këtë ligj.*

III.1.16. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "*Euro Mega 2010*" SHPK, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP-së, konkretisht shkresës me nr. 69/2 prot., datë 02.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 971/5 prot., datë 08.05.2024, me objekt "*Dërgohet vendim mbi ankesën*", si dhe shkresës nr. 3676/1 prot, datë

28.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 971/10 prot, datë 29.05.2024 me objekt "*Kthim - përgjigje*", dërguar nga Agjencia Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, nga informacioni i dërguar nga ana e autoritetit kontraktor konstaton, se nuk është ndërmarrë asnjë hap procedural në zbatim të nenit 23, gërma "ç" dhe "l" të LPP-së dhe nenit 23 e vijues të ligjit nr. 43/2023, datë 03.07.2023, për adresimin e problematikës së konstatuar pranë organeve kompetente të caktuara me ligj si më sipër cituam, ndaj KPP gjykoi, se për sqarimin e fakteve, është e nevojshme mbajtja e një seance dëgjimore në prezencë të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik ankimues. Me shkresën nr. 971/7 prot, datë 10.05.2024, njoftoi palët e sipërcituara që më datë 13.05.2024, ora 12:30, të paraqiten pranë ambienteve të Komisionit të Prokurimit Publik për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe ballafaqimin e palëve në proces, në lidhje me pretendimet e tyre për sa i përket ofertës ekonomike të ngarkuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Në datën 13.05.2024, ora 12:30, në prani të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor z. I. N dhe E. M, përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues "*Euro Mega 2010*" SHPK z. K. SH, dhe në prani të Komisionit të Prokurimit Publik, u cel seanca dëgjimore, me regjistrim audio të saj. Në seancë, nga ana e Komisionit u pyeten palët nëse kanë kërkesa paraprake. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues u konfirmua se nuk ka kërkesa paraprake, ndërsa përfaqësuesit e autoritetit kontraktor paraqitën në seancë parashtrimet e tyre me shkrim, të cilat u administruan në dosjen objekt - shqyrtimi me nr. 971/8 prot, datë 13.05.2024. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua operatorit ekonomik ankimues, duke i kërkuar që të logohet në llogarinë e tij në sistemin e prokurimit elektronik, në seksionin operatori ekonomik, për të verifikuar ofertën e dorëzuar prej tij në këtë procedurë prokurimi, nëse janë 1 (një) apo 2 (dy) oferta të ngarkuara. Pasi përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues "Euro Mega 2010" SHPK u logua në sistemin e prokurimit publik në llogarinë e tij si operator ekonomik, u shfaq imazhi i dokumenteve të ngarkuara në SPE, në seksionin oferta të dorëzuar nga ky operator ekonomik, ku evidentohet dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën "oferta burgjeve FINALE10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf (303,9 kB)". Gjithashtu operatori ekonomik hyri në llogarinë e tij në SPE edhe te rubrika mesazhe, ku vërehen mesazhet e ardhura në SPE pas veprimeve të kryera nga operatori ekonomik, nga ku konstatohet, se veprimi për fshirjen e ofertës së parë të dorëzuar nga operatori me të dhënat Oferta ekonomike_6507b83a-51a8-461f-b1d2-d0c8f25d9d7a.pdf është realizuar në datën 20.03.2024 ora 10:58, dhe ngarkimi i ofertës përfundimtare me emërtesen oferta e burgjeve FINALE_10421f09-89f8-4a5f-ad2b-81b0dfb83bd9.pdf në SPE, më datë 20.03.2024 ora 10:56, ndërkohë që afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 20.03.2024 ora 11:00. Për rrjedhojë veprimet e kryera në sistem nga ana e operatorit ekonomik, rezultojnë të jenë kryer brenda afatit kohor të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimi.

Pas këtij veprimi procedural, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, konkretisht z. I. N, që të logohet në sistemin e prokurimit elektronik në seksionin e autoritetit kontraktues, për të verifikuar dokumentacionin e dorëzuar në skedarin e ofertave të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues "Euro Mega 2010" SHPK, pra për të verifikuar ofertën e dorëzuar prej këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi, nëse operatori ekonomik ka dorëzuar 1 (një) apo 2

(dy) oferta në SPE. Pasi përfaqësuesi i autoritetit kontraktor u logua në sistemin e prokurimit publik, në llogarinë e tij si autoritet kontraktor, u shfaq imazhi i dokumenteve të ngarkuara në SPE në seksionin oferta, të dorëzuara nga operatori ekonomik "Euro Mega 2010" SHPK, ku evidentohet dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën "oferta burgjeve FINALE.pdf (311165) krijuar më datë 20.03.2024 ora 10:56" dhe dokumenti i ngarkuar në PDF me emërtesën "oferta ekonomike.pdf (312661), krijuar më datë 19.03.2024 ora 13:55".
Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Në nenin 2 "Qëllimi", të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik", parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik*", ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

Në këtë rast, veprimet procedurale të ndjekura nga autoriteti kontraktor, nuk janë transparente dhe në çdo rast mund të krijojnë dyshime lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Autoriteti kontraktor duhet të kishte bërë një hetim të thelluar në lidhje me problematikën e konstatuar, duke ua adresuar atë institucioneve të ngarkuara me ligj të posaçëm, dhe pasi të merrte asistencën e duhur, të vepronte në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me problematikën e konstatuar, pasi nga verifikimi i bërë në seancën dëgjimore të datës 13.05.2024 pranë ambienteve të Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se operatori ekonomik, veprimet procedurale në sistemin e prokurimit publik, i ka kryer brenda afateve ligjore të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, dhe nuk është faji i tij, që sistemi nuk ka pasqyruar/ruajtur të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ky i fundit në SPE, duke sjellë edhe skualifikimin e tij nga ana e autoritetit kontraktor në mënyrë jo të drejtë.

Sa më sipër, mungesa e transparencës lidhur me hapat proceduralë të ndjekur nga autoriteti kontraktor, por dhe funksionimi i sistemit të prokurimit elektronik, në thelb shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit, duke krijuar hapësirë për vlerësim subjektiv. KPP nënvizon, se në respekt të parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve, jo vetëm kriteret e kualifikimit, por edhe procedurat verifikuese të ndjekura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor, me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme dhe transparente, jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë pjesëmarrës, por edhe për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, në mënyrë të tillë, që procesi i vlerësimit të kryhet në transparencë të plotë dhe jo me subjektivizëm; si dhe të vendosë në situatë të barabartë të gjithë ofertuesit, duke rritur besimin e subjekteve në një procedurë prokurimi. KPP sqaron, se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik është edhe ai i sigurimit të integritetit, besimit të publikut dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se problematika e konstatuar në këtë procedurë prokurimi objekt-shqyrtimi cenon në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenon parimin e sigurisë juridike dhe sigurimit të integritetit. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr. 12/2014, datë 17.03.2014, është shprehur se "*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*". Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia, në vendimin 15/2010, ka theksuar se "*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion*

*shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*".

III.1.17. Në nenin 118, pika 2, gërma "b" të Ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", sipas të cilit: "*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma "d*" të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*". Në nenin 45, pika 1 gërma "b" të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", ku parashikohet se: *"[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" [...]*". Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se problematika e konstatuar në sistemin e prokurimeve elektronike për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, për faj as të operatorit ekonomik ankimues por edhe as të autoritetit kontraktor, i cili gjendej përpara faktit se në llogarinë e tij në SPE u konstatuan dy oferta aktive, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, si dhe i propozon dy institucioneve kompetente të sipërcituara që të marrin masat e nevojshme, në mënyrë që problematika e konstatuar të mospërsëritet më, pasi një konstatim i tillë mund të cenojë parimin e sigurisë juridike, integritetin, dhe besimin publik në procedurat e prokurimit publik, pasi qëllimi i ngritjes dhe funksionimit të sistemit të prokurimeve elektronike në thelb, nuk ka për qëllim kufizimin, por efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik. KPP thekson, se sistemi i prokurimit elektronik nëpërmjet të cilit realizohen procedurat e prokurimit publik, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të rritjes së integritit, besimit publik, transparencës dhe efiçencës, parashikuar në nenin 2 të LPP-së.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*Euro Mega 2010*" SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "*Euro Mega 2010*" SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "*Malvina Visoka*" PF dhe "*AN&RA*" SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt - ankese do të anulohet, pretendimet e tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë*

*prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik"*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*", me Nr. *REF - 90711 - 12 - 12 - 2023*, me objekt: Loti I "*Projekti dhe instalimi i sistemit Photovoltaic për DRSHTRR Tiranë",* me fond limit 16.241.856 (*gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzetë e njëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës, të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dy institucione të ngarkuara më ligj të posacëm për mbarvajtjen, funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të prokurimit publik, për marrjen e masave, për parandalimin e problematikave të sipërcituara.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*Euro Mega 2010*" SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| **Fiorent Zguro** | **Kreshnik Ternova** | **Anila Malaj** | **Gjergj Mersini** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2024.06.13
05:01:18

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2024/06/13 09:00:21 +02'00'
60094a9587de42e9a0d7d78b0368e51e20240613 09001439020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*